

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY



FAKULTETI JURIDIK
ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ
FACULTY OF LAW

FAKULTETI JURIDIK
STUDIME PASDIPLOMIKE- CIKLI I DYTË

TEZA E MASTERIT:
PRINDËRIA E THEMELUAR ME ANË TË INSEMINIMIT ARTIFICIAL
E drejta dhe liria reproduktive

Kandidati:

Ledina Kamberi - Bauta

Mentori:

Doc. dr. Arta Selmani - Bakiu

Tetovë, shkurt 2020

DEKLARATA E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time personale, deklaroj se përmbajtja e temës së magjistraturës së paraqitur është punë origjinale e shkruar prej meje, e cila nuk është prezantuar asnjëherë para ndonjë institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij. Të gjitha referencat dhe citimet në tekst janë bërë në bazë të burimeve të paraqitura në fusnota.

Në të kundërtën pranoj të gjitha përgjegjësitë të cilat mund të më ngarkohen nga cilido komision apo organ që eventualisht do të shqyrtojë ndonjë rast ankese apo mosmarrëveshje lidhur me përmbajtjen e punimit, dhe në të njëjtën kohë pranoj të gjykohej në bazë të rregullores dhe statutit të Universitetit dhe ligjit mbi të drejtën e autorit.

Me respekt

Ledina Kamberi - Bauta _____

()

Abstrakt

Zhvillimet e shpejta teknologjike kanë ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në disa institute të së drejtës e veçanërisht në institutin e së drejtës familjare. Falë metodave të reja biomedicinale ekziston mundësia që të zgjidhen problemet në lidhje me infertilitetin. Një ndër këto metoda është inseminimi artificial, një institut i ri në shkencën dhe të drejtën familjare dhe biomedicinë në RMV. Në këtë punim, autorja analizon ligjin për inseminim të ndihmuar biomedicinal, gjithashtu në punim jep detajet lidhur me procedurën e përgjithshme të inseminimit artificial, kushtet për ushtrimin e të drejtës për inseminim të ndihmuar biomedicinal, siguria e dhurimit, përpunimi, shpërndarja dhe aplikimi i qelizavë, të drejtat dhe detyrimet e pacientit, shëndeti etj. Pjesë e veçantë në këtë punim i kushtohet shqyrtimit të të drejtave prindërore për çiftet të cilët nuk mund të kenë fëmijë në rrugë natyrore si dhe të drejtën e fëmijës për të njohur prejardhjen biologjike. Gjithashtu, në punim, autorja jep pikëpamjet e ndryshme lidhur me debatet ligjore, religjioze, morale dhe etike për prindërinë e themeluar sipas metodave të reja riprodhuese. Në bazë të hulumtimeve konkrete, në këtë punim arrihet një konkluzion rreth asaj se si pranohet aplikimi i metodave biomedicinale në shoqërinë tonë. Autorja në këtë punim mbron tezën se zhvillimi i shpejtë i bioteknologjisë dhe mjeksisë riprodhuese si dhe aplikimi i këtyre metodave shpien deri në fragmentimin e konceptit të prindërisë dhe familjes tradicionale si dhe dëmton rrënjët e saj atëherë kur këto metoda nuk zbatohen brenda standardeve ligjore, etike dhe morale.

Fjalët kyçe: inseminimi artificial, teknologjitë e reja artificiale reproduktive, prindëria, prejardhja biologjike e fëmijës.

Abstract

Rapid technological developments have directly affected some law institutes, especially the family law institute. Thanks to new biomedical methods, there is a possibility to solve problems related to infertility. One of these methods is artificial insemination, a new institute in science and family law and biomedicine in RNM. In this paper, the author analyzes the Law on Biomedicinal Assisted Insemination, as well as details of the general artificial insemination procedure, the conditions for exercising the right to assist insemination biomedicinal, donation security, processing, distribution and cellular application, patient rights and obligations, health, etc. Particular attention in this paper is devoted to the examination of parental rights for couples who can't have children on natural roads. Also in the paper, the author gives various views on legal, religious, moral and ethical debates on parenthood established under the new reproductive methods. Based on concrete research, this paper also provides an answer to how the application of biomedical methods in our society is accepted. The author in this article defends the thesis that the rapid development of biotechnology and reproductive medicine and the application of these methods leads to fragmentation of the concept of traditional parenting and family and damages its roots when these methods are not applied within legal, ethical and moral.

Key words: artificial insemination, new artificial reproductive technologies, parenthood, the biological origin of the child.

Апстракт

Брзиот технолошки развој има директно влијание врз некои правни институти, особено институтот за семејство. Благодарение на новите биомедицински методи, проблемите со неплодност можат да се решат. Еден од овие методи е вештачко оплодување, нов институт во семејната наука и право и биомедицина на РСМ. Во овој труд, авторот го анализира Законот за биомедицинско потпомогнато оплодување, исто така детали за општата постапка на вештачко оплодување, условите за остварување на правото на биомедицинско оплодување, безбедност на донаторите, обработка, дистрибуција и примена на клетки, права и обврски на пациентот, здравје, итн. Посебен дел во овој труд е посветен на испитување на родителските права за парови кои не можат да имаат деца со природни средства, како и на правото на детето да го знае биолошкото потекло. Исто така, во трудот, авторот дава различни ставови за правни, религиозни, морални и етички дебати за родителството утврдени со нови репродуктивни методи. Врз основа на конкретните истражувања, овој труд заклучува за тоа како се прифаќа примената на биомедицинските методи во нашето општество. Авторот во овој труд ја брани тезата дека брзиот развој на биотехнологијата и репродуктивната медицина и примената на овие методи доведува до фрагментација на концептот на традиционалното родителство и семејство и ги оштетува неговите корени кога овие методи не се применуваат во рамките на правните, етичките и морал.

Клучни зборови: вештачко оплодување, нови вештачки репродуктивни технологии, родителство, биолошка потекло на детето.

Përmbajtja

Deklarata e autorësisë

Abstrakt

Hyrje.....	3
Qëllimet e hulumtimit.....	5
Hipotezat.....	6
Metodologjia e hulumtimit.....	7
Rëndësia e punimit.....	8

KAPITULLI I PARË:

Bioteknologjia në raport me çështjet etike dhe ligjin si dhe roli i disa prej organizatave ndërkombëtare mbi bioetikën.

1.1 Bioteknologjia në raport me etikën dhe ligjin.....	9
1.1.2 Metodot e riprodhimit artificial dhe çështjet etike.....	10
1.2 Roli i organizatave ndërkombëtare mbi bioetikën.....	13
1.2.1 Organizata e kombeve të bashkuara.....	13
1.2.2 Bashkimi Evropian.....	15
1.2.3 Këshilli i Evropës.....	16

KAPITULLI I DYTË:

2.1 Inseminimi artificial dhe metodat e tjera të riprodhimit.....	18
2.1.1 Inseminimi artificial.....	20
2.1.2 Fekondimi autolog dhe alogjen.....	20
2.2 Koncepti i prindërimit.....	22
2.2.1 Procedura e inseminimit artificial sipas Ligjit për inseminim të ndihmuar biomedicinal.....	22
2.3 Institucionet e autorizuara shëndetësore për kryerjen e inseminimit të ndihmuar biomedicinal.....	25
2.4 Komisioni shëndetësor për inseminimin e ndihmuar biomedicinal.....	27

2.5	Përparësitë dhe të metat e inseminimit artificial.....	29
2.6	Amësia surrogate.....	31
2.6.1	Të drejtat prindërore dhe statusi i bartëses së shtatzanisë dhe i çiftit bashkëshortor.....	36
2.7	Riprodhimi artificial post mortem.....	38

KAPITULLI I TRETË:

3.1	E drejta e fëmijës për të njohur prejardhjen biologjike.....	42
3.2	Raste nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e njeriut mbi mbrojtjen e të drejtës së identitetit.....	48
3.3	Kufizime të përgjithshme për persona të caktuar që kanë të drejtë akses në metodat e reja riprodhuese.....	53
3.4	Anketë.....	57
3.5	Konkluzione dhe Rekomandime.....	62

Përfundimi

Literatura

Hyrje

Të qenët prindër është jashtëzakonisht e rëndësishme prej momentit që dy njerëz vendosin të lidhin bashkë jetën, mirëpo jo të gjithë e arrijnë këtë në mënyrë natyrale. Falë metodave të reja biomedicinale ekziston mundësia që të zgjidhen problemet në lidhje me infertilitetin. Ndër këto metoda do të përmenden: *inseminimi artificial* i cili është një institut i ri në shkencën dhe të drejtën familjare dhe biomedicinë në RMV, dhe duke marrë parasysh këtë metodë në këtë tezë të magistraturës do të analizohet ligji për inseminim të ndihmuar biomedicinal, gjithashtu në punim do të jepen detajet lidhur me procedurën e përgjithshme të inseminimit artificial, kushtet për realizimin e të drejtës për inseminim të ndihmuar biomedicinal, siguria e dhurimit, përpunimi, shpërndarja dhe aplikimi i qelizave, të drejtat dhe obligimet e pacientit, punëtorëve shëndetësorë dhe të institucioneve shëndetësore, etj; *reproduksioni posthuman, amësia surrogate etj.* Pjesë e veçantë në këtë punim do t' i kushtohet shqyrtimit të të drejtave prindërore për çiftet të cilat nuk mund të kenë fëmijë në rrugë natyrore. Është e nevojshme të përcaktohet nëse zhvillimi i një shoqërie dhe evoluimi i tillë i konceptit të riprodhimit dhe prindërisë është i pranueshëm nga normat etike dhe morale, poashtu është i nevojshëm përcaktimi i të drejtave dhe kufizimeve të pjesëmarrësve që do të marrin pjesë në aplikimin e këtyre metodave, duke patur parasysh interesin më të lartë të fëmijës. Në shumicën e legjislacioneve që e rregullojnë zbatimin e këtyre metodave ekziston një konsensus i heshtur në aplikimin e maksimës së njohur romake *Mater semper certa es* (nëna çdo herë është e njohur- ajo që lind fëmijën). Nga kjo rezultojnë edhe debatet të cilat janë ngritur për sa i përket çështjeve morale, etike, filozofike dhe juridike të cilat ndër të tjera sjellin pasojë mbi statusin juridik të fëmijës dhe konceptin e prindërisë. Përdorimi i këtyre metodave poashtu ka krijuar edhe debate për sa i përket çështjes ligjore e veçanërisht statusit të subjekteve që do të marrin pjesë dhe të fëmijës, që lind si rrjedhojë e aplikimit të tyre.

Subjektet të cilët kanë të drejtë të shfrytëzojnë metodat e reja për riprodhim artificial përveç prindërve ligjor të fëmijës përfshijnë edhe dhuruesit e materialit gjenetik apo personat e tretë ose nëna e cila mban fëmijën e porositur gjatë shtatzanisë.

Procesi i lindjes së fëmijës me marrëveshje paraprake ndërmjet prindërve juridik dhe gruas e cila do të mbajë fëmijën e porositur edhe pse është i rregulluar me norma ligjore përsëri hap

diskutime të shumta në shkencën juridike - familjare, në biomedicinë si dhe fusha të ndryshme të cilat merren me këto çështje. Prandaj, në të shumtën e rasteve është e nevojshme të përcaktohet statusi i personave të tretë si dhe marrëdhëniet ligjore të tyre me prindërit e fëmijëve dhe me vetë fëmijën. Duke marrë parasysh modelin tradicional të familjes, metodat e reja biomedicinale dhe zhvillimi i shpejtë i tyre paraqesin një temë e cila sjell pasoja të shumta si në konceptin e prindërisë ashtu edhe atë të fëmijës. Këto diskutime kanë hapur debate të ndryshme dhe jo të gjitha shoqëritë apo shkencëtarët e ndryshëm e kanë pranuar njësoj.

Në kapitullin e parë të këtij punimi trajtohet bioteknologjia si koncept në raport me çështjet etike dhe juridike si dhe disa prej organizatave ndërkombëtare, siç janë: OKB, BE, KE të cilat trajtojnë disa çështje të bioetikës, në kapitullin e dytë sqarohen disa prej metodave riprodhuese, siç janë: inseminimi artificial, reproduksioni posthuman, amësia surrogate etj. Në kapitullin e tretë trajtohet çështja e prejardhjes biologjike të fëmijës, gjithashtu raste të ndryshme të këtyre metodave si dhe aspekti moral dhe etik i tyre. Në pjesën e fundit të punimit, vërtetohen hipotezat e parashtruara, paraqiten përfundimet konkrete nga hulumtimi i realizuar si dhe jepen rekomandime konkrete për evitimin e konflikteve dhe zbrazëtirave ligjore.

Qëllimet e hulumtimit

Duke marrë parasysh se aplikimi i këtyre metodave është shumë evident si dhe personat që aplikojnë këto metoda janë gjithmonë e më shumë në rritje, në këtë punim pasqyrohet rregullimi i përgjithshëm përmes normave ligjore.

Një ndër qëllimet më të rëndësishme të këtij hulumtimi është vërtetimi i konceptit të prindërisë, a ka ndryshuar ky koncept me aplikimin e metodave të reja biomedicinale si dhe a ekziston e drejta absolute për t'u bërë prind.

Qëllim tjetër i këtij punimi është analiza e statusit juridik të fëmijës të lindur nga metodat e riprodhimit artificial dhe respektimi i interesit më të lartë të fëmijës.

Duke marrë parasysh interesin më të lartë të fëmijës dhe ndikim që kanë këto metoda mbi statusin e tyre, në këtë punim pasqyrohen konfliktet ligjore të cilat mund të lindin si pasojë e aplikimit të dispozitave ligjore mbi situatat e lindura nga aplikimi i metodave riprodhuese.

Qëllim tjetër i rëndësishëm është edhe mbledhja e të dhënave nga shoqëria jonë për të arritur në përfundimin se sa është e pranueshme qasia në metodat e reja riprodhuese dhe si mendojnë ata në lidhje me këtë.

Gjithashtu, jepen të dhëna rreth hulumtimeve të bëra në praktikën juridike vendase si dhe të huaj, duke analizuar në këtë aspekt shumë raste të paraqitura para Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut. Përmes një kërkimi të detajuar teorik dhe praktik, punimi do të japë pasqyrë rreth aplikimit të këtyre metodave duke u fokusuar në këtë aspekt në interesin më të lartë të fëmijës së lindur përmes këtyre metodave, duke veçuar në këtë aspekt të drejtën e tij për të njohur prejardhjen biologjike.

Hipotezat

Në këtë hulumtim qëllimi kryesor ka të bëjë me implikimet të cilat vijnë si pasojë e aplikimit të metodave të riprodhimit artificial, të statusi juridik i fëmijës si dhe të konceptit i prindërisë. Me aplikimin e metodave të reja biomedicinale ndryshon edhe koncepti i prindërisë për arsye se tashmë nuk mund të thuhet se fëmija vjen në jetë vetëm përmes aktit seksual apo rrugës natyrore.

Në këtë studim parashtrihen dy hipoteza kryesore, vërtetimi i të cilave e përbën edhe qëllimin e studimit. Ato janë:

1. E drejta absolute për t'u bërë prind dhe respektimi i interesit të prindërve.
2. Statusi juridik i fëmijëve të lindur me metodat e riprodhimit artificial dhe respektimi i interesit më të lartë të fëmijës.

Lidhur me këto hipoteza pasojnë disa pyetje hulumtuese:

1. Çfarë implikimesh sjellin këto metoda? Me anë të këtyre metodave a respektohet interesi i personave për t'u bërë prindër? A ka ndryshuar koncepti i prindërisë?
2. A respektohet interesi më i lartë i fëmijës së lindur me anë të metodave të riprodhimit artificial.

Sipas pyetjeve të bëra vijojnë këto hipoteza:

1. Zhvillimi i shoqërisë dhe evoluimi i tillë i konceptit të riprodhimit dhe prindërisë nuk është plotësisht i pranueshëm nga normat etike dhe morale. Gjatë aplikimit të ndonjërisë nga metodat e riprodhimit artificial është i nevojshëm të përcaktohen të drejtat dhe kufizimet e pjesëmarrësve në aplikimin e këtyre metodave, si dhe të bëhet harmonizimi i ligjeve me Konventat e ratifikuara, duke pasur parasysh interesin më të lartë të fëmijës.
2. Zhvillimi i shpejtë i bioteknologjisë dhe mjekësisë riprodhuese si dhe aplikimi i këtyre metodave shpjen deri në fragmentimin e konceptit të prindërimit dhe familjes tradicionale. Mirëpo, jo gjithmonë këto metoda kanë efekte negative pasi falë tyre

zgjidhen problemet në lidhje me infertilitetin si dhe probleme të tjera shëndetësore që ndoshta pa këto metoda nuk do të zgjidheshin.

Metodologjia e hulumtimit

Nëpërmjet disa metodave analizohet koncepti i prindërisë i cili me aplikimin e metodave të reja riprodhuese ka pësuar ndryshime. Jetojmë në një periudhë ku zhvillimi i shkencës e sfidon progresin e njerëzimit me mënyrat e teknologjisë. Konceptit prindëror dhe statusit të fëmijës i cili lind me anë të materialit gjenetik të donuar u është kushtuar një vëmendje e posaçme pasi për këto janë ngritur dilema të shumta juridike, morale dhe etike të cilat duhet të shqyrtohen nga shkenca e cila merret me vetë qënien njerëzore.

Metodologjia e cila përdoret për këtë hulumtim bazohet në një studim të thellë dhe të kujdesshëm. Hulumtimi mbështetet në të dhëna, burime të ndryshme, udhëzime dhe këshilla nga ana e mentores të cilat kanë rëndësi të madhe për shkrimin e këtij punimi.

Metoda e anketës është pjesë shumë e rëndësishme e këtij hulumtimi. Anketa është përdorur si mjet i mbledhjes së të dhënave nëpërmjet së cilës është fituar një pasqyrë se çfarë mendojnë persona të kategorizuar sipas moshës për aplikimin e këtyre metodave të riprodhimit artificial.

Për hulumtim më të hollësishëm poashtu janë përdorur edhe disa metoda të poshtëshënuara:

Metoda normative - me të cilën nxirren në pah ndryshimet e reja me të cilat përballet prindëria;

Metoda juridike - analitike e cila ka shërbyer për të analizuar teoritë mbi implikimet etike të cilat vijnë nga aplikimi i këtyre metodave, si dhe mbledhjen dhe analizimin e problemeve ligjore që lindin si rrjedhojë e këtyre implikimeve;

Metoda krahasuese - me anë të së cilës do të jepen të dhëna rreth hulumtimeve të bëra në praktikën juridike vendase si dhe të huaj, duke analizuar në këtë aspekt shumë raste të paraqitura para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

Metoda empirike - nëpërmjet së cilës analizohen të dhënat dhe rezultatet statistikore nga e kaluara dhe janë nxjerrë gjykime në lidhje me temën e caktuar.

Rëndësia e punimit

Siç është cekur edhe më lartë, ky punim është i një rëndësie të veçantë dhe është punim i parë i magistraturës në gjuhën shqipe. Pasi aplikimi i metodave të riprodhimit artificial dhe zhvillimi i shpejtë i tyre e ka vendosur përpara një sfide institutin e prindërisë është e nevojshme të përcaktohet nëse zhvillimi i një shoqërie dhe evoluimi i tillë i konceptit të familjes dhe prindërisë është i pranueshëm nga normat etike, morale dhe juridike. Me rëndësi është edhe përcaktimi i të drejtave dhe kufizimeve të pjesëmarrësve të cilët aplikojnë metodat e riprodhimit artificial duke pasur parasysh gjithmonë interesin më të lartë të fëmijës.

Çështjet kryesore që shtrohen për diskutim i drejtohen faktit nëse zhvillimi i mëtejshëm i këtyre teknologjive do të dëmtojë mirëqenien e fëmijës, do të dëmtojë prindërinë, apo do të ndikojë në konceptin e riprodhimit. Aplikimi i këtyre metodave dhe lindja e fëmijëve të parë nga riprodhimi artificial si dhe rregullimi ligjor i realizuar nga disa shtete perëndimore bëri që aplikimi i këtyre metodave të konsiderohej i pranueshëm dhe duke marrë parasysh se aplikimi i këtyre metodave është shumë evident si dhe personat që aplikojnë këto metoda janë gjithmonë e më shumë në rritje, vendosa të shkruaj për temën e lartëpërmendur me dëshirën më të madhe për të arritur në një përfundim të mirëfilltë duke dhënë konkluzionet dhe rekomandimet e mia.

KAPITULLI I PARË

Bioteknologjia në raport me çështjet etike dhe ligjin si dhe roli i disa prej organizatave ndërkombëtare mbi bioetikën

1.1 Bioteknologjia në raport me etikën dhe ligjin

Bioteknologjia si koncept shpeshherë i referohej vetëm zhvillimit të teknologjisë ushqimore, mirëpo me lindjen e inxhinierisë gjenetike origjina e bioteknologjisë pësoi një zhvillim. Rritja e aksesit në metodat e reja riprodhuese fillimisht u përhap në shtetet e Evropës, ndërsa më vonë edhe në vendet anglo-amerikane, mirëpo ndërmjet tyre ekzistonin dallime për sa i përket aksesit në këto teknika.

Çështjet etike të cilat lindin me aplikim e metodave të riprodhimit artificial apo me zhvillimin e shpejtë të teknologjisë gjejnë trajtim në disiplinën e bioetikës. Termi “bioetikë” për herë të parë u përdor nga Van Rensselaer Potter në vitin 1970¹, i cili si pikë fillestare e paraqet fillimin e një dimensionit të ri me një qëndrim kritik ndaj jetës dhe sfidave të reja të shkencës të cilat ndryshojnë nga ajo që deri tash kemi njohur.² Domethënë, bëhet fjalë për një disiplinë e cila në mënyrë të pashmangshme integron në shumë fusha, në mënyrë që të mund të mbledhë, rafinojë, analizojë, sistemojë dhe rregullojë lëndët e para të mjekësisë, ligjit, psikologjisë, etikës, sociologjisë, filozofisë, në mënyrë që të ofrojë zgjidhje të shëndosha për sfidat e reja të shkencës.³

Pas Potter-it, rëndësi të veçantë për fillimin e kësaj shkence ka edhe Andre Hellegers.⁴ Ky autor bioetikën e përdor si një mjet për të zgjidhur dilemat morale me të cilat përballet zhvillimi i mjekësisë, e cila padyshim dhe menjëherë duhet të vendosë standarde. Standarde dhe norma (dimensioni juridik) të tilla janë të nevojshme për të kornizuar dhe kufizuar njeriun në

¹ Елена Игновска, “Биорепродуктивна етика и право. Новите репродуктивни технологии и родителското право”. Shkup, 2010.

² Po aty, fq.23

³ Po aty

⁴ Po aty

nxitjen e tij shkencore, në mënyrë që të përcaktohet se sa larg mund të shkojë njeriu në krijimin artificial të funksioneve natyrore dhe jetës njerëzore, pa u larguar nga riprodhimi natyror.⁵ Nga pikëpamja juridike, bioetika duhet t'u përgjigjet pyetjeve që i imponon zhvillimi i shkencës mjekësore mirëpo të cilat nga pikpamja etike janë të ndaluara.⁶

1.1.2 Metodat e riprodhimit artificial dhe çështjet etike

Metodat e riprodhimit artificial mundësojnë riprodhimin në kushte të cilat nuk janë identike me riprodhimin natyror. Me zbatimin e këtyre metodave, realizohen disa mënyra të riprodhimit artificial të cilat në disa raste janë afër riprodhimit natyror me çka fëmijët janë gjenetikisht të lidhur me prindërit mirëpo ka raste kur fëmija dhe prindi nuk kanë asnjë lidhje gjenetike me njëri tjetrin dhe mund të themi se kjo është larg riprodhimit natyror. Përdorimi i këtyre metodave si dhe e drejta për riprodhim ka arritur në një shkallë ku nuk kërkohet vetëm nga çiftet infertile, por edhe nga persona të cilët janë beqar, nga grate të cilat janë në moshën e menopauzës, gratë e veja si dhe nga çiftet homoseksuale. E gjithë kjo mundësi dhe fuqi që iu ofrohet individëve me aplikimin e teknikave të riprodhimit mund të çojë drejt një revolucioni i cili mund të ndryshojë njerëzimin dhe fatin e tij mirëpo gjithmonë duhet pasur parasysh që këto të përdoren për të mirën e njerëzimit.

Bioteknologjia bëri të mundur aplikimin e metodave riprodhuese siç janë inseminimi artificial, amësia surrogate, lindja e fëmijës nga një grua me material gjenetik të donuar, zënia e fëmijës nga tre persona, fekondimin post-mortem, e me këto tashmë është e vështirë të thuhet se këto metoda ngjajnë me riprodhimin natyror. Ekzistojnë edhe procese të tjera siç janë: zgjedhja e gjinisë së fëmijës, përmirësimi i kapaciteteve fizike, intelektuale të fëmijës së ardhshëm, klonimi, të cilat ende konsiderohen juridikisht të ndaluara.

⁵ Елена Игновска, “Биорепродуктивна етика и право. Новите репродуктивни технологии и родителското право”. Fq.25, Shkup, 2010.

⁶ По аты.

E dreja reproduktive është një nga të drejtat themelore të njeriut. Kjo e drejtë në kuadër të këtyre metodave nuk është më çështje e kontrollit njerëzor dhe që varet vetëm nga natyra.⁷ Në kuadër të kësaj të drejte prindërit me dëshirën e tyre vendosin se a do të bëhen prindër tani ose me vonë, a do ta tejkalojnë sterilitetin dhe të zgjedhin njërin nga këto metoda, a do të dëshirojë fëmijë me material gjenetik të donuar apo do të përdorin aftësinë e vet riprodhuese etj.⁸

Shekuj me radhë riprodhimi është konsideruar vetëm si një mënyre për ta forcuar lidhjen ndërmjet çifteve dhe krijimin e një familje sëbashku. Duke marrë parasysh edhe të drejtën islame Allahu i Lartësuar e bëri martesën si formë të vetme me të cilën mundësohet lidhja ndërmjet burrit dhe gruas, krijohet familja dhe lihen pasardhësit. Për këtë, martesë në Islam është e shenjtë dhe fisnike, e ndërtuar me pëlqim nga të dy anët, harmonisë dhe dashurisë së ndërsjellë. Prandaj, dispozitat që kanë të bëjnë me inseminimin artificial dhe metodat që përdoren, janë plotësisht të lidhura me këtë dhe dispozitat që përcaktohen rreth tyre, kanë për qëllim ndërtimin dhe ruajtjen e dinjitetit të familjes.⁹

Sa i përket këndvështrimit Islam rreth fëmijëve që lindin si rezultat i këtyre metodave se a konsiderohen fëmijë të ligjshëm apo jo, dijetarët që debatuan në këtë kongres theksuan se përmes këtyre dy metodave: - 1. Të merret sperma dhe vezorja nga burri dhe gruaja që kanë kurorë dhe pasi të bëhet fekondimi në epruvetë, të mbillet kjo në mitrën e të njëjtës grua. 2. Të bëhet fekondimi i brendshëm dhe kjo realizohet në këtë formë që të merret sperma e burrit dhe të trajtohet në mënyrë speciale dhe me anë të injeksionit të bëhet hedhja e saj në traktin gjenital të femrës dhe kjo grua të ketë kurorë me burrin nga i cili merret sperma, konsiderohen si fëmijë legjitim sipas shariatit dhe ata kanë po të njëjtat të drejta si fëmijët e zakonshëm, si atësia, trashëgimia etj.¹⁰ Ndërsa fëmijët e lindur nga aplikimi i metodave të tjera të riprodhimit artificial konsiderohen fëmijë jo legjitim dhe dispozita rreth tyre është e njëjtë sikurse fëmijët që lindin jashtë kurorës, pra trajtohen si fëmijë të zinasë (që lindin nga burri dhe gruaja që nuk kanë kurorë).¹¹

⁷ Елена Игновска, “Биорепродуктивна етика и право. Новите репродуктивни технологии и родителското право” fq.39. Shkup, 2010.

⁸ Po aty, fq. 39

⁹ <https://kohaislame.com/fekondimi-artificial-in-vitro/>, marrë më 11.12.19

¹⁰ <https://kohaislame.com/fekondimi-artificial-in-vitro/>, marrë më 11.12.19

¹¹ Po aty, marrë më 11.12.19

Duke e parë në këtë aspekt zhvillimi i shpejtë i metodave të riprodhimit artificial e ndan konceptin e riprodhimit nga ai i seksualitetit, me aplikimin e tyre ky fenomen shihet si një e drejtë që e gëzon kushdo, poashtu ekziston liria e zgjedhjes për të pasur pasardhës ose jo si dhe liria në caktimin e metodës të cilën duan ta përdorin. Sot nuk ekziston koncepti unik për familjen i cili më herët përfaqësohej nga nëna, babai dhe fëmijët, për shkak se kemi familje monoprinçerore qofshin ato të krijuara nga shkurorëzimi, reproduksioni post-mortem apo nga një nënë beqare, familje të rekonstruuar ku dy çifte sjellin fëmijë nga ish-martesa në martesën e re në të cilën lindin fëmijë të tjerë të përbashkët dhe familje të homoseksualëve.

Pavarësisht diskutimeve negative të cilat shpeshherë janë paraqitur kundrejt të drejtës për riprodhim, kjo nuk sanksionohet në asnjë Kushtetutë, madje as në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe as në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, mirëpo përsëri autorë të shumtë aplikimin e këtyre metodave e lidhin me të drejtën për të pasur familje. Këto të drejta janë të parapara në dokumentet ndërkombëtare, ku thuhet *“Burra dhe gra të moshës madhore, pa asnjë kufizim mbi baza kombësie ose feje, kanë të drejtë të martohen dhe të krijojnë familje”*¹², ndërsa në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut thuhet se *“Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare”* si dhe *“Çdokush ka të drejtë të martohet dhe të krijoj familje”*¹³

Me aplikimin e metodave të riprodhimit artificial janë zhvilluar debate të shumta, çështjet kryesore të cilat edhe sot po diskutohen kanë të bëjnë me atë se a do të ndikojnë këto metoda në kuptimin e riprodhimit, a do të dëmtohet mirëqenia e fëmijës së lindur nga aplikimi i këtyre apo nëse këto metoda do të dëmtonin prindërinë. Lindja e fëmijëve të parë bëri të mundur që këto metoda të konsideroheshin të pranuar nga pikpamja etike dhe duke marrë parasysh faktin se me aplikimin e këtyre metodave u mundësohej çifteve infertile që të linin pasardhës, realizimi i tyre kishte një arsye më shumë për t'u përkrahur.

Shpeshherë zhvillimet teknologjike tentojnë që të bëjnë ndryshime në shoqëri duke modifikuar edhe parimet në të cilat mbështetet ajo shoqëri. Duke marrë parasysh modelin tradicional dhe biologjik të familjes në shoqërinë tonë, metodat e reja riprodhuese zgjojnë një

¹² Neni 116 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut

¹³ Neni 8 dhe 10 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut

kureshtje diskutimesh mbi etikën, filizofinë dhe rregullimin juridik të riprodhimit të qënies njerëzore, dhe kërkojnë kështu përgjigje të cilat duhet të kenë një raport midis vlerave morale shoqërore dhe zhvillimeve teknologjike dhe mjekësore.

1.2 Roli i organizatave ndërkombëtare mbi bioetikën

Për shkak të faktit se zbatimi i teknikave të riprodhimit artificial nuk kufizohet vetëm në një shtet të caktuar por ka përmasa ndërkombëtare, është me rëndësi të përmendet edhe roli i disa prej Organizatave Ndërkombëtare të cilat kanë trajtuar çështje etike që janë pasojë nga aplikimi i këtyre teknikave. Nga vetë fakti që këto organizata kanë kontribuar në fushën e bioteknologjisë dhe bioetikës nënkuptohet rëndësia që kanë këto teknika në jetën e njeriut, edhe pse këto organizata kanë për fokus mirëqenien njerëzore dhe jo mjekësinë apo teknologjinë ato kanë trajtuar këto çështje pasi janë pikërisht këto të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në jetën e njeriut.

1.2.1 Organizata e Kombeve të Bashkuara

Organizata e Kombeve të Bashkuara është një prej organizatave më të mëdha në botë e themeluar në vitin 1945 pas Luftës së Dytë Botërore. Roli thelbësor i saj është ruajtja e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, bashkëpunimi midis shteteve të botës, zhvillimin ekonomik, poashtu ka rol të rëndësishëm në respektimin e të drejtave të njeriut dhe të dinjitetit njerëzor.¹⁴

Programi bioetik i UNESCO-s u krijua në vitin 1993. Ai i përket programit etik të shkencës dhe teknologjisë së UNESCO-s. Suksesi i parë dhe me i madh i saj ndodhi në vitin 1997, kur Konferenca e Përgjithshme miratoi Deklaratën Universale mbi Gjenomin Njerëzor dhe të Drejtat e Njeriut, ishte i vetmi instrument ndërkombëtar në fushën e bioetikës, i cili u miratua

¹⁴<https://www.un.org/un70/en/content/history/index.html>, marrë më 05.10.2019

nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në 1998.¹⁵ Në nenin 1 të kësaj deklaratë thuhet se gjenomi njerëzor nënkupton unitetin themelor të të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore, si dhe njohjen e dinjitetit dhe diversitetit të tyre të pandarë. Në kuptimin simbolik, është trashëgimia e njerëzimit.¹⁶ Kjo Deklaratë ka për qëllim që të rrisë respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut edhe në metodat e reja bioteknologjike.

Programi bioetik i UNESCO-s, zhvilloi katër fusha kryesore të veprimit:¹⁷

1) Forumin intelektual: Programi siguron një forum intelektual për reflektim multidisiplinar, pluralist dhe multikulturor mbi bioetikën, veçanërisht përmes komitetit ndërkombëtar të bioetikës dhe komitetit ndërqeveritar të bioetikës duke organizuar dhe marrë pjesë në konferenca, simpoziume, etj. UNESCO-ja synon në këtë mënyrë të nxisë debatin kombëtar dhe ndërkombëtar për çështjet kryesore etike që dalin nga zhvillimet e fundit në shkencat e jetës dhe aplikimet e tyre në mënyrë që të hartojnë udhëzime etike për bashkësinë ndërkombëtare dhe shtetet anëtare.¹⁸

2) Veprimi i vendosjes standarde: Programi synon të përcaktojë dhe promovojë një kornizë të përbashkët etike për përcaktimin e standardeve që shtetet mund të përdorin në formulimin dhe vënien në praktikë të politikave të tyre në fushën e bioetikës. Suksesi i parë dhe më i madh i programit në këtë fushë ishte miratimi i Deklaratës Universale mbi Gjenomin dhe të Drejtat e Njeriut nga Konferenca e Përgjithshme e UNESCO-s në 1997.¹⁹

Duke patur parasysh një qëllim të tillë UNESCO-ja miratoi Deklaratën Universale mbi Bioetikën dhe të Drejtat e Njeriut. Kjo Deklaratë edhe pse nuk ishte e detyrueshme për zbatim, solli risi duke marrë parasysh se kjo Deklaratë ishte instrumenti i parë ligjor që kishte për qëllim të bëjë orientimin e shteteve antëtare për mënyrën e aplikimit të këtyre metodave si dhe lidhjen e parimeve bioetike me liritë dhe të drejtat e njeriut. Nëpërmjet kësaj deklaratë synohet që të rritet cilësia e jetesës, mirëqënia familjare si dhe respektimi i të drejtave të njeriut duke i përdorur këto

¹⁵ <http://www.unesco.org/new/en/social-and-human-sciences/themes/bioethics/about-bioethics/>, marrë më 15.10.2019

¹⁶ Art (neni) 1, The Unesco Declaration on Human Genom and Human Rights, 1997.

¹⁷ <http://www.unesco.org/new/en/social-and-human-sciences/themes/bioethics/about-bioethics/>, marrë më 15.10.2019

¹⁸ Po aty.

¹⁹ Po aty.

metoda në mënyrë efikase dhe duke i shërbyer sa më shumë njeriut. Kjo Deklaratë u drejtohet në përgjithësi të gjitha shteteve anëtare dhe jo në veçanti personave të cilët do të bëjnë zbatimin e këtyre metodave.²⁰

3)Roli këshillues dhe krijimi i kapaciteteve: Programi vepron si një këshilltar për shtetet anëtare. Gjithashtu, kontribuon në ndërtimin e kapaciteteve nacionale dhe rajonale duke lehtësuar krijimin e rrjeteve të institucioneve dhe specialistëve të interesuar në bioetikë, dhe inkurajon krijimin ose forcimin e qendrave rajonale të informacionit dhe dokumentacionit të bioetikës. Programi përpiqet të identifikojë çështje etike për rajone të veçanta në një përpjekje për të përcaktuar dhe zbatuar strategji të përshtatshme për promovimin dhe zhvillimin e reflektimit etik në këto fusha.²¹

4)Edukimi dhe ndërgjegjësimi: Programi merr pjesë në edukimin dhe ndërgjegjësimin për bioetikë midis specialistëve (studiues, juristë, gazetarë, etj.), vendimmarrësve, publikun e gjerë dhe grupe specifike të synuara. Në nivelin universitar, lehtësohet bashkëpunimin rajonal midis universiteteve dhe UNESCO-s në edukimin e bioetikës. UNESCO-ja gjithashtu identifikon universitetet që ofrojnë arsim të bioetikës në mënyrë që të nxisin shkëmbimet, veçanërisht duke i lidhur ato me rrjetin e institucioneve për edukimin e etikës mjekësore.²²

1.2.2 Bashkimi Evropian

Bashkimi Evropian është një organizatë e cila kishte fillimisht qëllim të bashkëpunimit ekonomik ndërmjet shteteve anëtare. Mirëpo, me zhvillimin e mëtejshëm shtetet anëtare nuk u fokusuan vetëm në çështjet ekonomike, por ato e shtrinë bashkëpunimin ndërmjet tyre edhe sa i përket demokracisë dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

²⁰ Art (neni) 2, The Unesco Declaration on Human Genom and Human Rights, 1997.

²¹ <http://www.unesco.org/new/en/social-and-human-sciences/themes/bioethics/about-bioethics/>, marrë më 16.10.2019

²² <http://www.unesco.org/new/en/social-and-human-sciences/themes/bioethics/about-bioethics/>, marrë më 16.10.2019

Bashkëpunimi midis shteteve anëtare u zhvillua edhe sa i përket çështjeve të shëndetësisë, të cilat u trajtuan veçanërisht që prej Traktatit të Maastriktit (1992). Për arsye të bashkëpunimit ndërmjet shteteve nënkuptohet se edhe rregullat për zhvillimin e mëtejshëm të teknologjisë apo çështjet etike duhet që të rregulloheshin në mënyrë të përbashkët, për këtë arsye u ngrit një komitet i specializuar në kuadër të Këshillit të Evropës i cili do të trajtonte çështjet etike. Më vonë me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës hyri në fuqi edhe Karta e të Drejtave të Njeriut e cila paraqiste një garanci më shumë për çështjet e bioetikës. Dokumenti i vetëm i Bashkimit Evropian ku mund të gjejmë sanksionet lidhur me liritë dhe të drejtat e njeriut si dhe disa nga parimet bioetike është Karta e të Drejtave të Njeriut. Në nenin e parë të kartës thuhet: “Dinjiteti njerëzor është i padhunueshëm. Ai duhet të mbrohet dhe të respektohet”. Në nenin 2 të Kartës thuhet: “Çdokush gëzon të drejtën e jetës”, mirëpo duke marrë parasysh se shtetet anëtare kanë qëndrime të ndryshme lidhur me statusin e embrionit në këtë nen nuk specifikohet fjala çdokush.²³

1.2.3 Këshilli i Evropës

Këshilli i Evropës është një organizatë e shteteve evropiane e themeluar më 5 maj 1949 për të arritur një bashkëpunim më të madh midis vendeve anëtare për sa i përket lirive dhe të drejtave themelore të njeriut.²⁴

Këshilli i Evropës duke marrë parasysh zhvillimin e shpejtë të teknologjisë në lidhje me çështjet e bioetikës dhe riprodhimin artificial krijoi grupin e punës mbi mbrojtjen e embrionit dhe fetusit. Raportin e parë grupi i punës e publikoi në vitin 2003.²⁵

²³Charter of Fundamental Rights of the European Union. 2007 <https://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:C:2007:303:0001:0016:EN:PDF>, marrë më 17.10.2019

²⁴<https://www.coe.int/en/web/yerevan/the-coe/about-coe>, marrë më 18.10.2019

²⁵ Raporti i grupit të punës, Strasburg viti 2003 [https://www.coe.int/t/dg3/healthbioethic/Activities/04_Human_embryo_and_fetus_en/CDBI-CO-GT3\(2003\)13E.pdf](https://www.coe.int/t/dg3/healthbioethic/Activities/04_Human_embryo_and_fetus_en/CDBI-CO-GT3(2003)13E.pdf), marrë më 18.10.2019

Sa i përket statusit të embrionit ka pesë teori. Sipas teorisë së parë embrioni apo statusi i embrionit duhet të konsiderohet i barabartë me qënien njerëzore. Ndalohet çdo veprim i cili mund të çojë deri në mos zhvillimin e embrionit.²⁶ Sipas teorisë së dytë embrioni ka vetëm një vlerë shumë të vogël dhe nuk gëzon të drejta sikurse qënia njerëzore. Dy teoritë e tjera janë të njohura si teoritë “gradualiste”, sipas tyre me zhvillimin e embrionit gradualisht rriteshin edhe të drejtat. Mirëpo edhe ndërmjet tyre kishte diskutime për arsye të faktit se kur embrioni do të fitonte të drejta të plota. Grupi i parë mendonte se me zhvillimin e tij embrioni fitonte të drejta por nuk e përcaktonte saktë se kur do të fitojë të drejta të plota, ndërsa grupi i dytë mendonte se embrioni do të fitojë të drejta të plota në çastin e lindjes.²⁷

Në këtë raport një çështje tjetër e cila u trajtua ishte edhe fati i embrionit. Rëndësi të veçantë për këtë ka plani i prindërimit, pra nëse ekziston një plan prindërimi apo dy persona të cilët i bashkojnë qelizat e tyre me qëllim prindërimi atëherë interesi i tyre do të jetë më i fortë se sa ai i personave të tretë. Nëse nuk ka një plan prindërimi atëherë ndërhyrja e shtetit do jetë me e fortë.²⁸ Në pjesët e tjera trajtohet poashtu fertilizimi in vitro, mirëpo karakteristik e veçantë është fakti që në këtë raport infertiliteti është shkaku kryesor i aplikimit të teknikave të reja riprodhuese dhe me këtë kuptohet se nuk parashikohet aplikimi për personat të cilët nuk janë infertil.

Në pjesën e pestë të këtij raporti trajtohen diagnozat para implementuese gjenetike, kjo dmth se kjo diagnozë përmes teknikave artificiale dhe analizës gjenetike të selektojë dhe të çojë në uterus vetëm embrionet e shëndosha dhe të paprekura nga anomalitë. Fillimisht me këtë parashikohej ndalimi i sëmundjeve të cilat ishin gjenetikisht të transmetueshme, mirëpo moralisht kjo ishte e papranueshme pasi do të bëhej krijimi i embrioneve me gjene të përzgjedhura dhe kjo shpie deri në njëfarë diskriminimi për qënien njerëzore.²⁹

²⁶ Raporti i grupit të punës, Strasburg viti 2003, fq.5
[https://www.coe.int/t/dg3/healthbioethic/Activities/04_Human_embryo_and_foetus_en/CDBI-CO-GT3\(2003\)13E.pdf](https://www.coe.int/t/dg3/healthbioethic/Activities/04_Human_embryo_and_foetus_en/CDBI-CO-GT3(2003)13E.pdf), marrë më 18.10.2019

²⁷ Po aty, fq.5

²⁸ Po aty, fq.9 The destiny of the embryo

²⁹ Po aty, fq.33 The reference to “eugenics”

KAPITULLI I DYTË

2.1 Inseminimi artificial dhe metodat e tjera të riprodhimit

Duke parë historikisht teknikat e para të riprodhimit artificial ato datojnë që nga shek. XV nga Mbreti Henri i IV i Kastilies, i cili ndryshe ishte i njohur me nofkën “impotent”. Mbreti Henri sëbashku me bashkëshorten e tij princeshën Juana pas gjashtë vjet martese sollën në jetë vajzën e tyre Joanna. Edhe pse nuk ka të dhëna zyrtare mendohej se princesha e vogël Joanna nuk ishte vajza e mbretit për shkak se nuk kishte ngajshmëri me të atin.³⁰

Më shumë se 100 vjet më vonë, në 1784, inseminimi i parë artificial u aplikua në një qen dhe u raportua nga shkencëtari Lazzaro Spallanzani (fiziolog italian, 1729-1799). Ky inseminim rezultoi në lindjen e tre qenve 62 ditë më vonë (Belonoschkin, 1956; Zorgniotti, 1975). Besohet se Spallanzani ishte i pari që raportoi efektet ftohëse të spermës së njeriut kur ai vuri në dukje, në 1776, që sperma e ftohur nga bora u bë e palëvizshme.³¹

Më vonë disa shekuj me radhë janë studiuar këto teknika për të parë se a do të rezultojnë të suksesshme. Aplikimi i teknikave të riprodhimit artificial për herë të parë gjen zbatim në vitin 1770, nga John Hunter në Londër i cili në historinë mjekësore është quajtur "themeluesi i operacionit shkencor", ai bëri përpjekje për të mbledh qelizat mashkullore dhe ti vendoste ato në trupin e femrës me qëllim të riprodhimit, mirëpo përsëri nuk ka të dhëna të sakta të cilat tregojnë se këto teknika të përdorura nga Hunter kanë qenë të suksesshme.³²

Në vitin 1884, Dr. William Pancost, për herë të parë, realizoi inseminim artificial zyrtar të një gruaje duke përdorur spermë të dhuruar. Inseminimi artificial nuk ishte i pranuar deri në vitin 1940, por dëshira për natalitet pas Luftës së Dytë Botërore, progresi i kontrollit të lindjes dhe "liberalizimi i normave shoqërore" kanë ndihmuar që inseminimi artificial të popullarizohet

³⁰ <https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC4498171/>, Artificial insemination history: hurdles and milestones. Marrë më 02.11.2019

³¹ Po aty, marrë më 02.11.2019

³² Po aty, marrë më 02.11.2019

më shumë.³³ Përpjekjet për të arritur deri në sukses nga këto metoda nuk janë ndaluar dhe kjo vërtetohet fillimisht edhe me lindjen e foshnjës së parë. Kjo nisi qysh në vitet e 50 të shek XX, por që rezultat pati pas 28 vitesh me lindjen e foshnjës së parë përmes këtyre metodave, e cila ishte Louise Brown të cilën shtypi e quajti “test – tube baby” (bebja epruvetë) pasi ajo ishte qenia e parë njerëzore që lindi me anë të inseminimit artificial.³⁴ Kjo lindje u realizua nga biologu Edwards dhe gjinekologu Steptoe përmes metodave të riprodhimit artificial in vitro.³⁵ Pikërisht viti 1987 bëri që bota të kuptojë se ekziston kjo mundësi e tillë për të siguruar pasardhës. Për metodat e riprodhimit artificial në fillim të viteve 80 nuk mund të thuhet më se ishin të pa suksesshme, pasi suksesi ishte arritur dhe tashmë këto metoda filluan të përdoren dhe vazhdojnë deri më sot, duke rezultuar në sfida serioze juridike, morale dhe etike.³⁶

Në vitin 1996 u bë shkatërrimi masiv i embrioneve, një rezultat i domosdoshëm i legjislacionit britanik që parashikon asgjësimin e embrioneve të ngrira pas pesë vitesh (neni 14.4 Fekondimi i njeriut dhe akti i embriologjisë, 1990), shkaktoi shqetësim në të gjithë botën. Sot, zhvillimet aktuale në teknikat e riprodhimit artificial e veçanërisht nëse flasim për klonimin shihet se ofrojnë sfidat më të fundit për ndërgjegjen e njerëzimit në lidhje me kriteret etike dhe juridike e kështu duke vlerësuar drejtësinë ose padrejtësinë e formave të reja të teknologjive në riprodhimin njerëzor. Nëse analizohet efekti themelor i këtyre teknikave të reja riprodhuese hasim në një problematikë shumë të madhe në të cilën gjejmë fillimin e shpëputjes së dy dimensioneve që deri atëherë kishin qenë të lidhura në mënyrë të pandashme: bashkimi seksual dhe aftësia për gjenerim.³⁷

³³ Arta Selmani, Стекнување на родителското право преку сурогат мајка- посебен осврт на Законот за изменување и дополнување на законот за биомедицинско потпомогнато оплодување (Proceeding of the Third International scientific conference Social change in the global world- Center for Legal and Political Research, Faculty of Law, Goce Delcev University, Shtip, Republic of Macedonia) p.129-152 , 2016, fq.132

³⁴ Hernan F. Corral, Professor Family Law Universidad de los Andes (Santiago de Chile) Filiation and Assisted reproductive Technology.(Trabajo publicado en Revue Générale de Droit (U. de Ottawa), No 31 (2001), fq. 3

³⁵ http://www.fvvo.be/assets/97/13-Ombelet_et_al.pdf, History of human artificial insemination. Fq.4, marrë më 03.11.2019

³⁶ Hernan F. Corral, Professor Family Law Universidad de los Andes (Santiago de Chile) Filiation and Assisted reproductive Technology.(Trabajo publicado en Revue Générale de Droit (U. de Ottawa), No 31 (2001), fq. 3

³⁷ По аты, fq. 3 dhe 4

2.1.1 Inseminimi artificial

Inseminimi artificial është një nga teknikat riprodhuese më të vjetra dhe me popullore. Realizimi i procedurës së fekondimit të ndihmuar biomjekësor, kryhet në mënyrën që siguron mbrojtjen e të drejtave të njeriut, dinjitetit dhe privatësisë së personave, te të cilët kryhet procedura mjekësore dhe të donatorëve të materialit gjenetik dhe të embrioneve. INB-ja kryhet me qëllim që të arrihet fekondimi në pajtim me përparimin shkencor teknik, shkencën mjekësore dhe përvojat, me theks të veçantë për të drejtat e njeriut.³⁸ Kjo procedurë realizohet nëse mjekimi paraprak është i pasuksesshëm, ose mjekimi me metoda të tjera është i pashpresë dhe në rastin kur sëmundja e rëndë trashëguese mund të bartet te pasardhësi.³⁹

Bëhet fjalë për një çështje e cila ndihmon në procesin riprodhues, respektivisht në vet mitrën e gruas pa marrëdhënie seksuale. Ky proces zanafillën e ka që në vitet e 50-ta të shekullit 20.⁴⁰ Në Republikën e Maqedonisë së Veriut për herë të parë është rregulluar në vitin 2008 me ligjin për inseminim të ndihmuar biomedicinal. Inseminimi artificial është një procedurë mjekësore që lejon bashkimin e qelizave seksuale mashkullore dhe femërore në një mënyrë të ndryshme nga ajo natyrore.⁴¹

2.1.2 Fekondimi autolog dhe alogjen

Në procedurën mbi inseminimin e ndihmuar biomedicinal përparësi u jepet përdorimit të qelizave seksuale vetanake të personave që aplikojnë inseminimin artificial, respektivisht embrionet e çifteve martesore apo jashtë martesore të cilët kanë vendosur të realizojnë procedurën (*fekondimi autolog*). Fekondimi bëhet me futjen e embrionit të fituar me qeliza seksuale personale apo të dhuruara të çiftit bashkëshortor në mitrën e femrës - bartëse e shtatzënisë.⁴²

Nëse në procedurën e INB-së nuk është i mundur shfrytëzimi i qelizave gjinore vetanake, të çifteve bashkëshortore ose jashtëmartesore, përkatësisht nëse ato nuk shfrytëzohen për

³⁸ Neni 2, Ligji për inseminim të ndihmuar biomedicinal, tekst i konsoliduar 6/25/2019

³⁹ Neni 3, po aty

⁴⁰ E. Donald Shapiro and Benedene Sonneblick. Widow and the sperm The law of post mortem insemination 1986 fq.229,234.

⁴¹ Neni 5, Ligji për inseminim të ndihmuar biomedicinal, tekst i konsoliduar 6/25/2019

⁴² Neni 6, po aty

pengimin e bartjes të sëmundjes së rëndë trashëguese të fëmija, mund të shfrytëzohen spermatozoide të dhuruar, qeliza vezë ose embrione nga personat e tjerë (*fekondim alogjen*).⁴³ Sipas Ligjit për inseminim të ndihmuar biomedicinal fekondimi autolog dhe alogjen kryhen përmes procedurave të mëposhtme mjekësore:

- 1) *Fekondimi i brendshëm*: Futja e spermatozoidit në organet seksuale femërore, futja e qelizës vezë sëbashku me spermatozoidin në organet seksuale femërore
- 2) *Fekondimi i jashtëm*: Bashkimi i qelizës vezë dhe spermatozoidit jashtë trupit të femrës dhe futja e tyre në organet seksuale femërore, futja e embrionit në organet seksuale femërore

Duke marrë parasysh nenin 9 të këtij ligji të drejtë për të përdorur procedurën e inseminimit kanë një pjesë e burrave dhe grave të aftë të cilët për shkak të arsyeve të cilat janë të parapara në nenin 3 të këtij ligji janë të martuar ose jetojnë në bashkësi jashtëmartesore e të cilët sipas moshës dhe gjendjes së përgjithshme shëndetësore janë të aftë për kujdesin prindëror. Martesa ose bashkësia jashtëmartesore nga neni 1 i këtij ligji duhet të ekzistojnë në momentin e zbatimit të procedurës. Poashtu, të drejtë për të shfrytëzuar procedurën e inseminimit artificial kanë gratë të cilat nuk janë në lidhje martesore apo në bashkësi martesore, nëse trajtimi i mëparshëm ka rezultuar i pasuksesshëm apo trajtimi me metodat e tjera është pa rezultat dhe të cilat sipas moshës dhe gjendjes së përgjithshme shëndetësore janë të aftë për kujdesin prindëror⁴⁴ Kjo teknikë realizohet në ato raste kur të paktën njëri prej partnerëve është steril dhe kur materiali i tij nuk është i përshtatshëm për riprodhim për shkak të sëmundjeve gjenetike të trashëgueshme. Përmes këtyre teknikave mund të dhurohen si qelizat mashkullore(sperma) ashtu edhe qelizat femërore (vezët).

Me rëndësi në këtë procedure është poashtu edhe këshillimi, para realizimit të procedurës mjeku i autorizuar në institucionin shëndetësor, është i obliguar që çiftit bashkëshortor ose jashtëmartesor ose femrës, t'ua sqarojë procedurën, suksesin e procedurës, si dhe pasojat dhe rreziqet e mundshme që mund të shkaktohen gjatë dhe pas përfundimit të çfarëdo procedure, gjatë procesit të inseminimit të ndihmuar biomedicinal.

⁴³ Neni 7 Ligji për inseminim të ndihmuar biomedicinal, tekst i konsoliduar 6/25/2019

⁴⁴ Neni 9, po aty.

2.2 Koncepti i prindërimit

Prindërimi është një institut i lashtë i cili barazohet me vetë njerëzimin. Koncepti i tij bazohet në raportin prind - fëmijë. Prindërit janë konsideruar dy persona të sekseve të kundërta të cilët kanë qënë në lidhje martesore dhe të cilët vendosin të riprodhohen dhe të lënë pasardhës, mirëpo ky realitet nuk është gjithmonë kaq afër ideale. Shumë fëmijë lindin prej prindërve të cilët nuk janë në një lidhje martesore midis tyre dhe në të tjera raste jo gjithmonë dy persona të rritur, për shkak të arsyeve biologjike, mund të riprodhohen dhe të lënë pasardhës. Si rrjedhojë e këtyre zhvillimeve sociale, prindëria mund të themi se ka ndryshuar konceptin e tij njëkohësisht me evoluimin e lirive dhe të drejtave të njeriut. E drejta për të pasur fëmijë është e drejta e çdo individi të krijoj familje përmes riprodhimit apo përmes ndonjë mënyre tjetër siç është adoptimi apo metodat e reja riproduktive. Koncepti i prindërimit tashmë ka ndryshuar dhe nuk mund të themi se është tërësisht një koncept biologjik.

2.2.1 Procedura e inseminimit artificial sipas Ligjit për inseminim të ndihmuar biomedicinal

Procedura e inseminimit artificial kryhet me kërkesë të çiftit martesor ose jashtëmartesor, por edhe femrës e cila nuk është e martuar ose nuk jeton në bashkësi martesore nëse paraprakisht janë të njohur me procedurën si dhe kanë dhënë deklaratë për pajtim me shkrim. Pëlqimi duhet të jepet për secilën procedurë veç e veç, duke marrë parasysh llojin e procedurës dhe prejardhjen e materialit gjenetik. Pëlqimi i dhënë për zbatimin e këtyre procedurave ka rëndësi juridike si deklarata për njohjen e atësisë respektivisht amësisë pas lindjes së fëmijës.⁴⁵ Femra ose mashkulli mund të tërheqin pëlqimin e tyre dhe të heqin dorë nga procedura përderisa spermatozoidi, qeliza vezë ose embrioni nuk futen në trupin e gruas. Deklaratën për tërheqjen e pëlqimit gruaja ose burri e japin me shkrim. Para futjes së spermatozoideve, qelizës vezë apo

⁴⁵ Neni 12, Ligji për inseminim të ndihmuar biomedicinal, tekst i konsoliduar 6/25/2019

embrionit në trup mjeku i gruas që kryen procedurën është i detyruar të kontrollojë nëse pëlqimi është terhequr apo jo.⁴⁶

Kjo procedurë inicohet me dorëzimin e kërkesës me shkrim të çiftit bashkëshortor në Ministrinë e Shëndetësisë, ndërsa me pëlqim paraprak me shkrim të bartëses potenciale të shtatzënisë dhe personit me të cilin femra-bartëse potenciale e shtatzënisë jeton në bashkësi martesore ose jashtëmartesore më gjatë se një vit.⁴⁷ Kërkesës për ngritjen e procedurës së inseminimit të ndihmuar biomedicinal me bartëse të shtatzënisë detyrimisht i bashkëngjitet vërtetim për këshillim të zbatuar psikologjik dhe juridik, dhe deklarata për pëlqim të bartëses potenciale të shtatzënisë dhe të çiftit bashkëshortor për zbatim të kësaj procedure me bartëse të shtatzënisë. Ministria e Shëndetësisë pas marrjes së kërkesës përcakton nëse janë plotësuar të gjitha kushtet e këtij ligji për ngritjen e procedurës së inseminimit të ndihmuar biomedicinal me bartës të shtatzënisë dhe me shkrim e njofton çiftin bashkëshortor dhe bartësen potenciale të shtatzënisë. Nëse janë plotësuar kushtet për ngritjen e procedurës me bartës të shtatzënisë, çifti bashkëshortor dhe bartësja potenciale e shtatzënisë lidhin marrëveshje për rregullimin e të drejtave dhe obligimeve të ndërsjella të cilat dalin nga ajo procedurë.⁴⁸ Të drejtë që të ngrejë procedurë të inseminimit të ndihmuar biomedicinal me bartësen e shtatzënisë kanë mashkulli dhe femra të cilët janë në martesë dhe janë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Personat në bashkësi jashtëmartesore ose në cilëndo qoftë formë tjetër të partneritetit nuk mund të ngrenë procedurë të inseminimit të ndihmuar biomedicinal me bartëse të shtatzënisë. Çifti bashkëshortor ka të drejtë të parashtojë kërkesë për ngritjen e procedurës me bartëse të shtatzënisë nëse femra nga çifti bashkëshortor ka mungesë të lindur/të fituar të mitrës ose anomali të lindur në mitër e cila nuk mund të korrigjohet me procedura kirurgjike moderne sipas mjekësisë të bazuar në dëshmi ose dëmtime të pakorrigjueshme të mitrës.⁴⁹ Çifti bashkëshortor ka të drejtë të parashtojë kërkesë për ngritjen e procedurës me bartëse të shtatzënisë nëse femra nga çifti bashkëshortor ka edhe mungesë të lindur apo të fituar të vezoreve ose anomali të lindur të vezoreve që nuk mund të korrigjohet me procedura moderne kirurgjike sipas mjekësisë së bazuar në argumente ose dëmtime jokorrigjuese të vezoreve. Çifti bashkëshortor ka të drejtë të

⁴⁶ Po aty.

⁴⁷ Neni 12-a, Ligji për inseminim të ndihmuar biomedicinal, tekst i konsoliduar 6/25/2019

⁴⁸ Po aty.

⁴⁹ Po aty.

parashtrijë kërkesë për ngritjen e procedurës me bartëse të shtatzanisë nëse mashkulli nga çifti bashkëshortor ka sterilitet që nuk mund të shërohet me procedura moderne sipas mjekësisë së bazuar në argumente. Si shkak për paraqitje të kërkesës për ngritjen e procedurës me bartëse të shtatzënisë nga ana e çifteve bashkëshortore pranohen edhe së paku tri tentime për shtatzëni të pasuksesshme të femrës nga çifti bashkëshortor kur si shkak i mosuksesit janë të përjashtuar të gjitha shkaqet dhe faktorët tjerë, përveç dëmtimeve të mitrës.⁵⁰ Si shkak për paraqitjen e kërkesës për ngritjen e procedurës me bartëse të shtatzanisë nga çifti martesor pranohet edhe ekzistimi i sëmundjes së gruas, të çiftit martesor e cila është kundëringdikuar me shtatzëni për shkak të komplikimeve të mundshme të vështira, të rrezikshme për jetën dhe me pasoja mbi gruan e çiftit martesor, përfshirë edhe vdekjen si epilog. Si përfundim i pasuksesshëm i procedurës së inseminimit të ndihmuar biomedicinal me bartëse të shtatzënisë konsiderohet procedura në të cilën është shkaktuar ndërprerja e shtatzënisë e dëshiruar dhe e padëshiruar dhe procedura në të cilën ka lindur fëmijë i vdekur.⁵¹ Në procedurën e inseminimit të ndihmuar biomedicinal me bartëse të shtatzënisë është e lejuar që në mitrën e bartëses së shtatzënisë të futen më së shumti dy embrione të fituar me qeliza seksuale personale apo të dhuruara të çiftit bashkëshortor. Çifti bashkëshortor ka për obligim që t'i marrë të gjithë fëmijët e lindur nga shtatzënia me më shumë fryte. Çifti bashkëshortor e ka për obligim që ta marrë fëmijën edhe nëse fëmija është i lindur me pengesa për shkak të të cilave ka nevoja të veçanta, e që nuk është zbuluar gjatë shtatzënisë me procedura standarde mjekësore.⁵²

⁵⁰ Neni 12-a, Ligji për inseminim të ndihmuar biomedicinal, tekst i konsoliduar 6/25/2019

⁵¹ Po aty.

⁵² Po aty .

2.3 Institucionet e autorizuara shëndetësore për kryerjen e inseminimit të ndihmuar biomedicinal

Procedurat e INB-së mund të realizohen vetëm në institucionin shëndetësor, i cili në bazë të ligjit për inseminim të ndihmuar biomedicinal ka autorizim nga Ministria e Shëndetësisë, për realizimin e procedurës së caktuar të INB-së.⁵³

Autorizimin Ministria e Shëndetësisë mund t'ia japë institucionit shëndetësor që ka hapësirë përkatëse, kuadër profesional dhe pajisje për:

- 1) realizimin e INB-së autologe brenda trupit;
- 2) realizimin e INB-së autologe jashtë trupit;
- 3) realizimin e INB-së alogjene brenda trupit, me shfrytëzimin e:
 - spermatozoideve të dhuruara dhe
 - qelizave vezë të dhuruara;
- 4) realizimin e INB-së alogjene jashtë trupit, me shfrytëzimin e:
 - spermatozoideve të dhuruara,
 - qelizave vezë të dhuruara dhe
 - embrioneve të dhuruara dhe
- 5) marrjen, testimin, përpunimin, ruajtjen dhe distribuimin e:
 - spermatozoideve,
 - qelizave vezë dhe
 - embrioneve.⁵⁴

Kushtet më të përafërta lidhur me hapësirën, kuadrin profesional dhe pajisjen i përcakton ministri i Shëndetësisë.⁵⁵

Ministria e Shëndetësisë i lëshon autorizim për miratimin e procedurave me propozimin e komisionit shtetëror, institucionit shëndetësor që i plotëson kushtet lidhur me hapësirën, kuadrin

⁵³ Neni 38, Ligji për inseminim të ndihmuar biomedicinal, tekst i konsoliduar 6/25/2019

⁵⁴ Po aty

⁵⁵ Po aty

profesional dhe pajisjen, për realizimin e procedurës së caktuar të INB-së. Ministri i Shëndetësisë mban regjistër të institucioneve të autorizuara shëndetësore, në të cilin përmbahen të dhënat për emrin dhe selinë e institucionit shëndetësor dhe procedurën e INB-së, që realizohet në institucion.⁵⁶

Ministri i Shëndetësisë mund ta heqë autorizimin nëse konfirmon se institucioni shëndetësor:

- 1) nuk i plotëson kushtet,
- 2) nuk i arrin rezultatet e pritura, në krahasim me institucionet e tjera të autorizuara shëndetësore,
- 3) nuk i përmbahet dispozitave të këtij ligji.⁵⁷

Propozim për heqjen e autorizimit e paraqet komisioni shtetëror.⁵⁸

Në realizimin e INB-së, obligativisht marrin pjesë:

- mjeku specialist i gjinekologjisë dhe akusherisë, me specializim më të ngushtë në sferën e riprodhimit human, me së paku pesë vite përvojë pune në këtë sferë dhe
- biologu i diplomuar me së paku tri vite përvojë pune në këtë sferë, ose mjeku ose farmacisti me edukim të veçantë plotësues dhe së paku tri vite përvojë pune, nga sfera e biomjekësisë ose embriologjisë humane.⁵⁹

Në realizimin e INB-së, mund të marrin pjesë edhe:

- mjeku specialist i gjinekologjisë dhe akusherisë, me së paku pesë vite përvojë pune në këtë sferë,
 - mjeku specialist i endokrinologjisë, me së paku pesë vite përvojë pune në këtë sferë dhe
 - mjeku specialist i urologjisë, me së paku pesë vite përvojë pune në këtë sferë.⁶⁰
- Punëtorët shëndetësorë dhe bashkëpunëtorët shëndetësorë që marrin pjesë në realizimin e INB-së, kanë të drejtë që për shkak të qëndrimeve të tyre etike, fetare ose morale, përkatësisht bindjeve, të thirren në ndërgjegjshmëri dhe kështu ta refuzojnë realizimin e procedurës së INB-së, ose pjesëmarrëjen në procedurë të atillë.⁶¹

⁵⁶ Neni 39, Ligji për inseminim të ndihmuar biomedicinal, tekst i konsoliduar 6/25/2019

⁵⁷ Neni 40, po aty.

⁵⁸ Po aty.

⁵⁹ Neni 41, Ligji për inseminim të ndihmuar biomedicinal, tekst i konsoliduar 6/25/2019

⁶⁰ Po aty.

⁶¹ Neni 42, Ligji për inseminim të ndihmuar biomedicinal, tekst i konsoliduar 6/25/2019

Institucionet e autorizuar shëndetësore janë të obliguar që të dërgojnë raport te komisioni shtetëror, për numrin dhe llojin e procedurave të kryera të INB-së, për suksesin e tyre, si dhe për spermatozoidet, qelizat vezë dhe embrionet që ruhen.⁶²

2.4 Komisioni shëndetësor për insemimin e ndihmuar biomedicinal

Komisionin shtetëror e përbëjnë:

-

- një jurist i diplomuar me së paku pesë vite përvojë pune në profesionin, përfaqësues i Ministrisë së Shëndetësisë,
- një jurist i diplomuar me specializim më të ngushtë nga e drejta familjare, ose të drejtat e njeriut,
- një psikolog ose punëtor social,
- një biolog i diplomuar me specializim më të ngushtë në sferën e riprodhimit human,
- një mjek specialist nga specializimi endokrinologji,
- tre mjekë specialistë nga specializimi gjinekologji dhe akusheri, me specializim më të ngushtë në sferën e riprodhimit human dhe
- një përfaqësues i Komitetit etik të Odës së mjekëve të Maqedonisë së Veriut.⁶³

Komisionin shtetëror e formon ministri i Shëndetësisë me propozimin e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, institucioneve shëndetësore që e kryejnë këtë veprimtari, Fakultetit të Mjekësisë, Odës së mjekëve të Maqedonisë së Veriut dhe institucioneve të tjera profesionale dhe shkencore, për periudhën prej pesë vitesh. Punët administrative-teknike për nevojat e

⁶² Neni 49 par.1, Ligji për insemimin të ndihmuar biomedicinal, tekst i konsoliduar 6/25/2019

⁶³ Neni 54, po i njëjti ligj.

komisionit shtetëror i kryen sekretari që nuk është anëtar i tij dhe i cili caktohet me aktvendimin për formimin e komisionit shtetëror nga radhët e të punësuarve në Ministrinë e Shëndetësisë.⁶⁴

*Komisioni shtetëror i kryen punët si vijojnë:*⁶⁵

- i propozon Ministrisë së Shëndetësisë dhënien përkatësisht heqjen e autorizimit të institucionit shëndetësor, për kryerjen e procedurës së caktuar të FNB-së,
- lejon inspektim në Regjistrin shtetëror, sipas nenit 55 të këtij ligji, - vendos për kërkesat nga neni 20 paragrafi 2 i këtij ligji,
- jep mendim për lejimin e kryerjes së punës shkencore hulumtuese, në pajtim me nenin 37 të këtij ligji,
- i shqyrton raportet e institucioneve shëndetësore, të dërguara sipas nenit 47 të këtij ligji,
- jep mendim paraprak për aktet nënligjore, që miratohen në bazë të këtij ligji,
- e përcjell përparimin e shkencave biomjekësore dhe të tjera në sferën e FNB-së, dhe sipas nevojës propozon ndryshimin dhe plotësimin e ligjit dhe akteve nënligjore,
- bashkëpunon me institucionet e autorizuara shëndetësore,
- e përcjell mbajtjen e Regjistrit shtetëror dhe - kryen edhe punë të tjera nga sfera e FNB-së, në pajtim me këtë ligj.⁶⁶

⁶⁴ Po aty

⁶⁵ Neni 55, Ligji për inseminim të ndihmuar biomedicinal, tekst i konsoliduar 6/25/2019

⁶⁶ Po aty

2.5 Përparësitë dhe të metat e inseminimit artificial

Përparësia e kësaj teknike qëndron në faktin se fëmija ka lidhje gjenetike të paktën me njërin prej prindërve kurse me tjetrin ka një lidhje ligjore. Përpara nisjes së procedurës prindërit e ardhshëm të fëmijës duhet të japin pëlqimin e tyre për realizimin e këtyre teknikave, gjë e cila është e nevojshme për të përcaktuar statusin ligjor të fëmijës. Si dhurues në këto teknika mund të jenë dhurues të panjohur të kontraktuar nga qendra shëndetësore në të cilën do të realizohet implementimi i qelizave.

Padyshim që dhurimi i qelizave është një mundësi alternative riprodhimi në rastin kur të paktën njëri prej partnerëve është steril ose vuan nga sëmundje të rrezikshme dhe gjenetike të trashëgueshme. Dhurimi i qelizave gjinore dhe lindja e fëmijës nga bartësja e shtatzënisë është vullnetar dhe pa kompensim.⁶⁷

Si e metë e kësaj teknike mund të përmendet fakti i mungesës së lidhjeve gjenetike midis fëmijës dhe të paktën njërit prej prindërve të tij, por edhe cënimin e të drejtës së fëmijës për të njohur prejardhjen e tij biologjike. Duhet theksuar se ligji për familje i RMV-së nuk lejon vërtetimin e atësisë së fëmijës i cili është mbarësuar me fekondim artificial.⁶⁸ Edhe në ligj mbrohet fshehtësia e të dhënave e cila shpeshherë cënon interesin më të lartë të fëmijës duke ia humbur të drejtën për të njohur prejardhjen e tij biologjike ose për t'ia humbur të drejtën të dijë se si ka ardhur në jetë.

Kështu duke u bazuar në ligj, institucionet e autorizuara shëndetësore janë të obliguara që ta sigurojnë mbrojtjen e të gjitha të dhënave personale, mjekësore dhe gjenetike për donatorin dhe pranuesin dhe të ndërmarrin masa të domosdoshme që identiteti i pranuesit të mos i zbulohet donatorit dhe familjes së tij dhe anasjelltas. Institucionet e autorizuara shëndetësore për zbatim të procedurës së INB-së me bartësen e shtatzënisë, institucionet shëndetësore ku bartësja e shtatzënisë e kontrollon shtatzëninë, institucioni shëndetësor ku femra bartëse e shtatzënisë ka lindur, organet tjera kompetente që marrin pjesë në zbatimin e procedurës së INB-së me bartësen e shtatzënisë, si dhe organet kompetente që zbatojnë procedurë për realizimin e të drejtave të

⁶⁷ Neni 18, Ligji për inseminim të ndihmuar biomedicinal, tekst i konsoliduar 6/25/2019

⁶⁸ Neni 62, Ligji për familje i RMV-së.

bartëses së shtatzënisë dhe të femrës nga çifti bashkëshortor të përcaktuara me këtë ligj, detyrohen të sigurojnë mbrojtjen e të gjitha të dhënave personale, mjekësore dhe gjenetike për bartësen e shtatzënisë, çiftin bashkëshortor dhe fëmijën, përkatësisht fëmijët të lindur nga procedura e INB-së me bartëse të shtatzënisë dhe të marrin masa të domosdoshme që të mos zbulohet identiteti i bartëses së shtatzënisë, çiftit bashkëshortor dhe fëmijës, përkatësisht fëmijëve të lindur nga procedura e INB-së me bartëse të shtatzënisë.⁶⁹

Poashtu, në bazë të ligjit ekziston edhe fshehtësia e të dhënave ku të gjithë personat që marrin pjesë në realizimin e procedurës së INB-së, janë të obliguar që t'i ruajnë si informatë të klasifikuar të gjitha të dhënat lidhur me procedurën, veçanërisht të dhënat personale dhe të dhënat për gjendjen shëndetësore të femrës dhe mashkullit, të cilëve u ofrohet ndihma mjekësore, fëmijës së ngjizur në procedurë dhe donatorët e qelizave gjinore dhe embrioneve.

Institucionet e autorizuara shëndetësore janë të obliguara që ta sigurojnë ruajtjen e të dhënave dhe dokumenteve për çdo donacion dhe për çdo prodhim të marrë nga donacioni, për donatorët, spermatozoidet, qelizat vezë dhe embrionet, me qëllim që të sigurohet vazhdimësi në të gjitha fazat e procedimit.

Fëmija i lindur pas fekondimit me qeliza gjinore ose embrione të dhuruara, nëse i ka mbushur 18 vjet dhe është i aftë që të gjykojë, mundet vetëm për shkaqe të arsyeshme mjekësore dhe me leje paraprake nga komisioni shtetëror, të kërkojë inspektim në të dhënat për gjendjen shëndetësore të donatorit ose donatorëve, në Regjistrin shtetëror për INB-në. Personi i autorizuar që e mban Regjistrin shtetëror, është i obliguar që pas kontrollit të kërkesës dhe konfirmimit se bëhet fjalë për personin nga paragrafi 1 i këtij neni, të mundësojë inspektim vetëm në të dhënat për gjendjen shëndetësore të donatorëve, pa i zbuluar të dhënat personale të tyre.⁷⁰

Në riprodhimin artificial heterolog të drejtat e fëmijës dhe dhuruesit janë vis a vis, pra kemi një përplasje me atë se në njërën anë qëndron fëmija dhe e drejta e tij për të njohur prejardhjen biologjike kurse në anën tjetër është dhuruesi dhe e drejta e tij për anonimitet. Kjo çështje sqarohet në detaje më poshtë kur bëhet fjalë për mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës.

⁶⁹ Neni 17, Ligji për inseminim të ndihmuar biomedicinal, tekst i konsoliduar 6/25/2019

⁷⁰ Neni 57, po aty.

2.6 Amësia surrogate

Funksioni riprodhues është çelësi i zhvillimit të familjes dhe shoqërisë. Kur bëhet fjalë për këtë e dimë se emocionet janë forca shtytëse në gjurmët e njeriut dhe ata kanë rolin kryesor në procesin riprodhues. Në hap me kohën jemi përballur me zhvillimin e shpejtë teknologjik.

Pamundësia e riprodhimit te disa partnerë për shkak të pengesave mjekësore që ato kanë ndikon në psikologjinë e partnerëve por në disa raste edhe në vazhdimësinë e jetës së tyre, prandaj mjekësia vazhdimisht kërkon mënyra për të korigjuar pengesat që çuan në të, domethënë për të kompensuar mangësitë. Por jo të gjitha alternativat janë moralisht të pranueshme.⁷¹

Vëmendje e veçantë i kushtohet edhe këtij instituti i cili është një risi në shkencën familjare dhe atë biomedicinale në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Amësia surrogate daton që nga fundi i vitit 2014, pasi kjo metodë ishte e ndaluar me ligjin për inseminim të ndihmuar biomedicinal të vitit 2008, por më vonë Kuvendi i RMV-së miraton *ligjin për ndryshime dhe plotësime të ligjit për inseminim të ndihmuar biomedicinal*. Me këtë ligj çifteve infertile u ofrohet një zgjidhje juridike për fitimin e të drejtës prindërore me çka edhe ata të cilët nuk mundën të kenë fëmijë në rrugë natyrore ta arrijnë këtë përmes kësaj metode.

Me surrogacion nënkuptojmë procesin e mbajtjes dhe lindjes së fëmijës për tjetrin, në bazë të një marrëveshje paraprake nga të dy palët: gruas mbajtëse/ nëna surrogate dhe prindërve juridik/ çiftit porositës.⁷² Qëllimi i kësaj metode nuk është që t'i mundësojë gruas lindjen e fëmijës sipas procesit natyror mirëpo ka si qëllim sjelljen në jetë dhe dorëzimin e fëmijës gruas e cila ka porositur. Nëna surrogate konsiderohet gruaja e cila e mbart shtatzaninë në placentën e saj por nuk është nëna biologjike. Gruaja e cila vendos që fëmijën që do ta lind t'ia japë; çiftit tjetër d.m.th menjëherë pas lindjes, duhet që të bëjë një marrëveshje paraprake te noteri, që me materialin gjenetik të prindërve porositës do ta mbaj dhe do ta lind fëmijën dhe në këtë drejtim

⁷¹ Маролов Дејан, Максимова Елена. Етичките аспекти на сурогатството наспроти ставовите на законската регулатива. fq.2 УДК: 618.177-089.888.11:340.13 (091)

⁷² Arta Selmani, Стекнување на родителското право преку сурогат мајка- посебен осврт на Законот за изменување и дополнување на законот за биомедицинско потпомогнато оплодување (Proceeding of the Third International scientific conference Social change in the global world- Center for Legal and Political Research, Faculty of Law, Goce Delcev University, Shtip, Republic of Macedonia) p.129-152 , 2016 , fq.135

ajo heq dorë nga amësia me nënshkrimin e kësaj deklarate dhe nuk ka të drejtë që më vonë të kërkojë dhe të vërtetojë amësinë, për shkak se ajo nuk ka lidhje gjenetike me fëmijën dhe shërben vetëm si një akt human nga ana e saj pasi për këtë proces nuk lejohet që të jepet kompenzim, në këtë rast çifti porosites ka për obligim të kujdeset që shtatzania të jetë e shëndoshë dhe të shkojë mirë poashtu, çifti porosites mund të japë një dhuratë në vlerë deri në 100 euro. Ajo çka është me rëndësi të përmendet është fakti se ekzistojnë disa kushte ku nëna surrogate kalon në disa këshillime juridike dhe një ndër to është e drejta që nënës surrogate nuk i lejohet pra, ajo nuk ka të drejtë që të ndërroëj mendim dhe të mos e japë fëmijën më pas.

Mirëpo, një pyetje tjetër e cila shtrohet ka të bëjë me atë se: A do ta marrë çifti “fëmijën e porositur” nëse ka anomali të lindura? Këto situata janë të paparashikueshme, por ato sigurisht që kanë pasoja të rënda, veçanërisht për një fëmijë i cili është i padëshiruar pas lindjes. Një rast që përfshin fëmijë të padëshiruar, i lindur me anë të surrogacionit është rasti i foshnjës Gami (Gammy) i lindur me sindromën Daun nga një nënë surrogate në Tajlandë i cili rast tronditi tërë publikun. Një çift australian, përmes një agjencie në Tajlandë, punësoi një vajzë të jetë nëna e tyre zëvendësuese. Nëna surrogate 21-vjeçare (Pattharamon Janbua) pranoi ofertën për shkak të vështirësive financiare që kishte në familje. Ajo mbeti shtatzënë me binjakë. Pas disa muajve të shtatzënisë është zbuluar se njëra nga foshnjat ka sindromën Daun. Çifti australian, pas lindjes morën vetëm vajzën e shëndetshme, duke e lënë djalin me sindromën Daun tek gruaja e varfër. Vajza që zëvendësoi vendosi të paguante borxhin e saj familjar dhe më pas nga situata e krijuar u bëri thirrje grave që të mos hyjnë në biznesin e surrogacisë. "Mos mendoni vetëm për para ... nëse diçka shkon keq, askush nuk do t'ju ndihmojë dhe fëmija gjithashtu do të braktiset nga shoqëria, në këtë rast ju do të duhet të merrni vetë përgjegjësinë për të", tha ajo.⁷³

Në vendet tjera nëse nuk mund të bëhet krijimi i embrionit nga materiali i prindërve porosites nëna surrogate mund të vërë në dispozicion materialin e saj gjenetik atëherë nëna surrogate do të jetë edhe gjenetikisht e lidhur me të. Shumë çifte, përfshirë këtu edhe çiftet homoseksuale në shtetin e të cilëve nuk lejohet amësia surrogate, punësojnë gra përmes agjencive të themeluara për këto çështje. Prindërit e jashtëm në shumë raste janë në kontakt me gratë që do të lindin fëmijën e tyre. Ata kujdesen për shëndetin e saj, duke mbajtur një shtatëzani

⁷³ Arta Selmani, Стекнување на родителското право преку сурогат мајка- посебен осврт на Законот за изменување и дополнување на законот за биомедицинско потпомогнато оплодување (Proceeding of the Third International scientific conference Social change in the global world- Center for Legal and Political Research, Faculty of Law, Goce Delcev University, Shtip, Republic of Macedonia) p.129-152 , 2016 , fq. 139

të shëndetshme dhe të gjitha shpenzimet e shtatzënisë. Këto gra ose vajza në të shumtën e rasteve kryejnë këtë veprim fisnik për shkak të kushteve të vështira ekonomike. Pas lindjes, fëmija regjistrohet se është lindur në një klinikë konkrete dhe përmes ambasadës së shtetit prindërve u jepet leja për ta marrë fëmijën.⁷⁴

Ekzistojnë dy lloje të amësisë surrogate, ajo tradicionale dhe gestacionale. Tradicionalja nënkupton inseminimin artificial in vitro të nënës surrogate me materialin gjenetik nga burri i cili dëshiron të jetë prindi i fëmijës dhe nëse partnerja e tij nuk mund të krijojë apo të mbart shtatzëninë. Amësia surrogate gestacionale kryhet përsëri me ndihmën e inseminimit artificial ku embrioni krijohet nga materiali gjenetik i burrit dhe gruas që dëshirojnë të jenë prindër, kështu që embrioni nuk ka lidhje gjenetike me nënën që e mbart atë. Pra, surrogacioni është një metodë e riprodhimit në të cilën një grua pranon të japë mitren e saj hua.⁷⁵

Sipas nenit 12-a të *ligjit për ndryshime dhe plotësime të ligjit për mbarësim të ndihmuar biomedical*, të drejtën e realizimit të kësaj metode e kanë femrat dhe meshkujt madhorë me aftësi të plotë për të vepruar, të cilët janë në martesë.

Procesin e amësisë surrogate nëpërmjet inseminimit të ndihmuar biomedical mundën ta inicojnë çiftet martesore në këto situata ligjore:

- nëse femra ka mungesë të lindur/të fituar të mitrës ose anomali të lindur në mitër e cila nuk mund të korrigjohet me procedura kirurgjike moderne ose ka dëmtime të pakorrigjueshme të mitrës,
- nëse femra nga çifti bashkëshortor ka edhe mungesë të lindur apo të fituar të vezoreve ose anomali të lindur të vezoreve që nuk mund të korrigjohet me procedura moderne kirurgjike ose ka dëmtime të vezoreve që nuk mund të shërohen,
- nëse mashkulli nga çifti bashkëshortor ka sterilitet që nuk mund të shërohet me procedura moderne,

⁷⁴ Arta Selmani, Стекнување на родителското право преку сурогат мајка- посебен осврт на Законот за изменување и дополнување на законот за биомедицинско потпомогнато оплодување (Proceeding of the Third International scientific conference Social change in the global world- Center for Legal and Political Research, Faculty of Law, Goce Delcev University, Shtip, Republic of Macedonia) p.129-152, 2016, fq.142

⁷⁵ Маролов Дејан, Максимова Елена. Етичките аспекти на сурогатството наспроти ставовите на законската регулатива. УДК: 618.177-089.888.11:340.13 (091), fq.3

- pas tri shtatzanive të pasuksesëshme

Edhe pse kjo mënyrë e përfitimit të së drejtës prindërore është e rregulluar me norma juridike përsëri nuk mungojnë diskutimet e shumta në fushën e të drejtës familjare, biomedicinë, etikë si dhe në fusha të tjera të cilat merren me çështjen e menaxhimit ekzistencial të njeriut. Së fundmi, e drejta për riprodhim dhe për të patur fëmijë e justifikon çdo metodë e cila përdoret për të arritur këtë rezultat. Procedura e amësisë surrogate duhet të bëhet pa kompensim, nëna surrogate ka të drejtë të pranojë dhuratë në vlerë jo më të lartë se 100 euro, mirëpo kush e siguron këtë? A ekziston një kontroll i cili vërteton se kjo është bërë pa përfitim? Mos vallë kjo do të rikthehet në një profesion me përfitime të mëdha? Dhe duke marrë parasysh të gjitha këto sa vlerë do të ketë koncepti familje?⁷⁶

Përveç shteteve që proklamojnë humanizmin e këtij procesi, në grupin tjetër janë vendet të cilët aplikojnë modelin e kompenzimit për nënën mbajtëse si dhe për institucionet (spitalet që ndërmjetësojnë amësinë surrogate). P.sh disa shtete siç janë:Ukraina, Rusia, Gjeorgjia, Tajlandi, India, disa shtete te SHBA-së, veçohen si shtete në të cilat surrogacioni është një biznes i zhvilluar. Disa nga kritikuesit e amësisë surrogate, instrumentalizimin dhe vënien në shërbim tëmitrës së gruas e konsiderojnë joetike dhe jomorale, madje këtë proces e konsiderojnë si një lloj turizmi riprodhues. Gjithashtu, e një rëndësie të konsiderueshme është edhe fitimi i të drejtës prindërore nëpërmjet kësaj mënyre biomedicinale.⁷⁷ Ligji parasheh regjistrimin e prindërve porositës si prindër biologjik të fëmijës në librin amë të të lindurve, me ç'rast nëna mbajtëse, nuk ka asnjë të drejtë dhe obligim prindëror ndaj fëmijës. Deklarata e dhënë për pëlqim për zbatimin e procedurës së inseminimit të ndihmuar biomedicinal ka rëndësi juridike të deklaratës për heqje dorë nga pranimi i amësisë pas lindjes së fëmijës, d.m.th , nëna mbajtëse nuk ka të drejtë të ngrejë procedurë për vërtetimin e amësisë apo realizim të drejtave prindërore në pajtim me dispozitat e ligjit për familjen. Kontraverziteti i rradhës shfaqet kur nëna mbajtëse duhet të ndjekë procedurën juridike për adoptim të fëmijës që ka lindur, në situatat kur prindërit juridikë janë të padenjë për të ushtruar të drejtën prindërore (ju hiqet aftësia për të vepruar ose hiqet e drejta prindërore). Në rast se ndodh vdekja e bashkëshortëve, nëna mbajtëse mundet të fitojë

⁷⁶ Arta Selmani – Bakiu, Artikull i botuar në Portalb, Tetova 1 dhe Zhurnal, viti i publikimit 25-03-2016, marrë më 10.06.2019

⁷⁷ Po aty

kujdestarinë mbi fëmijën e lindur, vetëm nëse fëmija nuk ka familjarë të afërt nga ana e prindërve juridikë. Ligji iu përkushton shumë pak vëmendje të drejtave të gruas surrogate, përveç kushteve dhe obligimeve ligjore dhe mjekësore të cilat ajo duhet t'i plotësojë që të realizojë shërbimin e suksesshëm të mbajtjes dhe dhurimin e fëmijës menjëherë pas lindjes. Ligji, gjithashtu, shumë pak i kushton rëndësi përcaktimit të statusit juridik të fëmijës së lindur nëpërmjet kësaj metode. Këto zbrazëtira juridike të këtij ligji, zgjojnë një pyetje tjetër me interes-ky ligj ka për qëllim mbrojtjen dhe realizimi e interesit vetëm të atyre që dëshirojnë të bëhen prindër, apo edhe mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës?⁷⁸

Ministria e Shëndetësisë e RMV-së doli me njoftimin zyrtar se pritet të realizohen edhe shtatzanitë e para surrogate. Nga kërkesat e aprovuara konstatohet se procesin e surrogacionit do ta realizojnë vetëm dy çifte martesore nëpërmjet dy nënave mbajtëse. Jozyrtarisht, njëra nënë mbajtëse do të jetë gjyshja e cila do të lindë fëmijën për vajzën e saj. Ndërsa për çiftin tjetër, fëmijën do ta mbajë dhe do ta lindë shoqja e nënës porositëse. I gjithë ky proces do të gjejë finalizimin e tij pas shqyrtimit dhe përmbushjes së të gjitha kushteve ligjore dhe procedurave juridike rreth kësaj mënyre të fitimit të prindërisë. Amësia surrogate është një proces juridik i rregulluar mirë dhe në detaje i me ligjin aktual. Paraqet një mundësi të re për formim të familjes për të gjithë ata çifte të cilët refuzojnë adoptimin si mënyrë juridike për t'u bërë prindër dhe insistojnë të kenë fëmijë me materialet e tyre gjenetike. Me fjalë tjera, rikthen shpresën për pasurimin e familjes me fëmijë. Mirëpo, edhe përkundër rregullimit statusor dhe ligjor të fitimit të të drejtës prindërore nëpërmjet kësaj metode biomedicinale, shumë çështje tjera lënë vend për t'u diskutuar edhe atë: ato psikologjike, etike, dhe problemet që ndërlidhen me mentalitetin e shoqërisë sonë për ta pranuar një mënyrë riprodiktive të këtij lloji për zgjerimin e familjes. Aspektet tjera shumë të ndjeshme rreth gjithë këtij procesi zbehin teorinë mbi shenjtërinë e procesit natyror të shtatzanisë. Progresi kaq i hovshëm i shkencës juridike-familjare anashkalon maksimumin e njohur romake *“Mater semper certa es”* (nëna çdo herë është e njohur- ajo që lindë fëmijën). Në çfarë këndvështrimi shoqëror dhe etik do të shikohet një grua e cila jep mitrën e saj

⁷⁸ Arta Selmani – Bakiu, Artikull i botuar në Portalb, Tetova 1 dhe Zhurnal, viti i publikimit 25-03-2016, marrë më 10.06.2019

me “qira”? Pasojat juridike dhe morale ndaj fëmijës, mbi të drejtën e tij për ta njohur nënën biologjike, i ka llogaritur dikush?⁷⁹

Ndonjëherë është e vështirë të përcaktohet ajo se çfarë saktësisht i frikëson njerëzit në lidhje me amësinë surrogate. Lindja e fëmijës dhe dorëzimi i saj, shfrytëzimi i grave dhe shtresës së varfër janë ato të cilat sulmojnë konceptin e familjes në këtë rast.

Si do të dukej fotografia e një nëne e cila mbart fëmijën për nëntë muaj dhe më pas e dorëzon? Surrogacia është gjithashtu shkatërruese për familjet në të cilat tashmë ekzistojnë fëmijët dhe gjyshërit, pasi ajo në mënyrë të pashmangshme do t'i dëmtojë ata pasi si mund t'i shpjegojë një nënë fëmijëve të saj që ajo po i jep ose po i shet të porsalindurit? Si mund t'i bëjë të besojnë se edhe ata nuk kanë një etiketë çmimesh? Përtej këtyre pyetjeve dhe dëmit që aksesit në këtë teknikë mund të shkaktojë ajo priret që gjithashtu të shkatërrojë edhe konceptin e familjes tradicionale.

2.6.1 Të drejtat prindërore dhe statusi i bartëses së shtatzënisë dhe i çiftit bashkëshortor

Bartësi i shtatzënisë nuk ka të drejta prindërore, as obligime ndaj fëmijës, përkatësisht fëmijëve që do t'i lindë.⁸⁰ Para se të ngrihet procedura e adoptimit të fëmijës, përkatësisht fëmijëve të lindur në procedurë të INB-së në rast kur ato janë lënë pa kujdes prindëror nga ana e çiftit bashkëshortor që është me vendbanim përkatësisht vendqëndrim të panjohur, më shumë se një vit ose pa marrë parasysh arsyet përkohësisht ose përherë nuk i kryen të drejtat dhe detyrat e veta prindërore, si dhe kur mashkullit dhe femrës nga çifti bashkëshortor u hiqet aftësia për punë ose u është hequr kryerja e të drejtës prindërore, femra bartëse e shtatzënisë ka të drejtë të regjistrohet si nënë e fëmijës, përkatësisht fëmijëve nëse i plotëson kushtet për adoptim të përcaktuara me dispozitat nga sfera e të drejtës familjare. Nëse femra bartëse e shtatzënisë nuk regjistrohet si nënë e fëmijës, përkatësisht fëmijëve në pajtim me këtë ligj, për mbrojtje të të drejtave dhe interesave të fëmijës, përkatësisht fëmijëve zbatohet procedurë në pajtim me dispozitat nga sfera e të drejtës familjare. Bartësja e shtatzënisë nuk ka të drejtë të ngrëjë

⁷⁹ Arta Selmani – Bakiu, Artikull i botuar në Portalb, Tetova 1 dhe Zhurnal, viti i publikimit 25-03-2016, marrë më 10.06.2019

⁸⁰ Neni 12-v, Ligji për inseminim të ndihmuar biomedicinal, tekst i konsoliduar 6/25/2019

procedurë për përcaktim të amësisë apo realizim të të drejtave prindërore në pajtim me dispozitat nga sfera e drejtës familjare.⁸¹

Çifti bashkëshortor ka të drejtë t'i kërkojnë ndërprerje të shtatzënisë bartëses së shtatzënisë nëse përcaktohen indikacione mjekësore në pajtim me dispozitat të cilat e rregullojnë ndërprerjen e shtatzënisë.⁸²

Të dhënat për bartësen e shtatzënisë dhe mënyrën në të cilën ai fëmijë është ngjizur dhe lindur mund t'i kumtohen fëmijës së lindur nga procedura e INB- së me bartëse të shtatzënisë pas mbushjes së pesë vjetëve jetë.⁸³

Si prindër të fëmijës, përkatësisht fëmijëve në librin e amzës së të lindurve regjistrohen femra dhe mashkulli nga çifti bashkëshortor me kërkesë të të cilit është ngritur procedura e INB - së me bartëse të shtatzënisë Organi kompetent për mbajtjen e librave të amzës të të lindurve i regjistron si prindër të femrës dhe mashkullit nga çifti bashkëshortor me kërkesë të të cilit është ngritur procedura e INB - së me bartëse të shtatzënisë, në bazë të vërtetimit të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë. Në rast të vdekjes së femrës dhe mashkullit nga çifti bashkëshortor me kërkesë të të cilit është ngritur procedura, që do të ndodhte gjatë shtatzënisë së bartëses së shtatzënisë, si prindër të fëmijës, përkatësisht fëmijëve pas lindjes së fëmijës, përkatësisht fëmijëve regjistrohet femra dhe mashkulli nga çifti bashkëshortor me kërkesë të të cilit është ngritur procedura e INB - së me bartëse të shtatzënisë, kurse e drejta e kujdestarisë realizohet në pajtim me dispozitat nga sfera e të drejtës familjare. Si kujdestar mund të vendoset edhe bartësja e shtatzënisë nëse fëmija si person nën kujdestari nuk ka farefis të gjallë të afërm. Nëse martesë e çiftit martesor me kërkesë të të cilit është ngritur procedura shkurorëzohet gjatë shtatzënisë së bartëses së shtatzënisë, për ruajtjen, mbajtjen dhe edukimin e fëmijës, përkatësisht fëmijëve që do të lindin zgjidhet në procedurë shkurorëzimi. Sa i përket bartëses së shtatzënisë ajo ka vetëm njëherë të drejtë që të lind një fëmijë të gjallë për dikë tjetër. Poashtu, çifti bashkëshortor dhe bartësja e shtatzënisë lidhin një marrveshje me të cilën i rregullojnë të drejtat dhe detyrimet e ndërsjellta.⁸⁴

Në situatën kur ekziston dyshimi se fëmija mund të ketë ndonjë anomali gjenetike të cilën mund ta trashëgojë nga prindërit e tij e veçanërisht nga nëna e cila mund të jetë bartëse e asaj anomalie

⁸¹ Po aty, paragrafi 2 dhe 3.

⁸² Po aty, paragrafi 4.

⁸³ Po aty, paragrafi 5.

⁸⁴ Po aty, paragrafi 6,7 dhe 8.

gjentike të trashëguar, në këtë rast lejohet kombinimi i mitokondrive të gruas së tretë me pjesë të ADN-së së prindërve dhe me anë të procesit të invitros të lind fëmijë. Mirëpo, në këtë rast ky fëmijë ka vulë gjenetike 1% edhe të gruas së tretë, prandaj kjo teknikë quhet lindje e fëmijës nga tre persona pasi që të tre marrin pjesë në krijimin e embrionit⁸⁵

2.7 Riprodhimi artificial post-mortem

Riprodhimi artificial post-mortem (për disa i njohur edhe si post-human) është një metodë e cila realizohet duke përdorur qelizat e ngrira. Kjo teknologji mundëson ngjizjen dhe lindjen e fëmijës pas vdekjes së njërit ose të dy prindërve. Këto qeliza implementohen pas vdekjes së babait biologjik dhe në këtë rast embrioni konsiderohet si embrion pas vdekjes. Me anë të kësaj metode burrit dhe gruas u mundësohet që përpara ndërmarrjes së ndonjë ndërhyrjeje dhe uljes së pjellorisë të bëjnë ngrirjen e qelizave në momentin kur ata janë pjellorë.

Kjo metodë është e rregulluar edhe në legjislacionin tonë pozitiv, kështu sipas ligjit për inseminim të ndihmuar biomedical thuhet: *“Burri dhe gruaja të cilëve sipas indiceve mjekësore ose përvojave nga shkenca mjekësore iu kërcënohet rreziku i infertilitetit për shkaqe shëndetësore, munden në institucionin e autorizuar shëndetësorë me deklaratën e tyre me shkrim ti ruajnë spermatozoidet e tyre, qelizat vezë, ose ind prej vezores ose testikujve për shfrytëzim personal. Në rast të vdekjes së burrit, inseminimi I ndihmuar biomedical post-human është i lejuar me pëlqimin e tij paraprak të dhënë në formë të shkruar, më së voni deri në 1 vjet nga vdekja e tij.”*⁸⁶

Riprodhimi post-mortem mund të realizohet për disa arsye, si: në rastin kur burri apo gruaja vuajnë nga ndonjë sëmundje e rëndë dhe zgjedhin që të ngrijnë qelizat e tyre; në rastin kur burri vuan nga ndonjë sëmundje atëherë ai zgjedh të bëjë ngrirjen e spermës; në rastin kur gruaja vuan nga ndonjë sëmundje bëhet ngrirja e qelizave vezë dhe pas vdekjes qeliza vezë e fekunduar

⁸⁵ <https://www.sciencenewsforstudents.org/article/how-make-three-parent-baby>, marrë më 11.06.2019

⁸⁶ Neni 33, Ligji për inseminim të ndihmuar biomedical, tekst i konsoliduar 6/25/2019

implantohet te nëna surrogate; rast tjetër është ngrirja e embrionit, pas vdekjes së njërit prind ose të dy prindërve embrioni i ngrirë implantohet në mitrën e një gruaje tjetër e cila do ta mbaj dhe lind fëmijën, në këtë rast realizohet reproduktimi post-mortem.

Për realizimin e kësaj metode dhe lidhur me përgjegjësinë prindërore, interesin më të lartë të fëmijës, lindjen, vdekjen, etj, janë hapur debate të shumta morale, etike dhe juridike.

Pyetja që shtrohet është se a ka një person të drejtën absolute të bëhet prind, të ketë një fëmijë? A vlen kjo e drejtë vetëm për riprodhimin seksual apo i mbulon të gjitha llojet e formave bio-mjekësore të fekondimit? A është liria riprodhuese e njeriut aq e gjërë sa që ai ka të drejtë të bëhet prind edhe pas vdekjes, duke përdorur teknikat e inseminimit artificial ose fekondimit in vitro. Nuk ka përgjigje të thjeshtë për të gjitha këto pyetje në legjislacionin modern. Shkencat shoqërore në përgjithësi, dhe veçanërisht ligji, janë shumë të ngadalta dhe të vështira për t'u përshtatur me zhvillimin e shpejtë të frikshëm të shkencës dhe teknologjisë, veçanërisht në fushën e bioteknologjisë dhe teknologjive të reja riprodhuese.⁸⁷

Në bazë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut çdo fëmijë ka të drejtë të dijë se kush janë prindërit e tij si dhe po të njëjtët të përkujdesen për të. Sa i përket fëmijës së lindur nga aplikimi i kësaj metode ekzistojnë pikpamje të ndryshme në lidhje me interesin e fëmijës. Kështu, sipas disa autorëve fëmija duhet të rritet nga të dy prindërit të cilët bashkë do të kujdesen për të, mirëpo në këtë rast kjo nuk është e mundur pasi njëri nga prindërit nuk do të jetë gjallë andaj kjo bie në kundërshtim me nenin 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe në këtë rast fëmijës i është hequr e drejta ende pa lindur, pra e drejta për t'u rritur në përkujdesjen e të dy prindërve dhe për të është paracaktuar që të jetojë vetëm me një prind.

Gjatë aplikimit të riprodhimit artificial post-mortem hasim probleme dhe një ndër to është statusi juridik i fëmijës. Duke marrë parasysh ligjin për trashëgimi në nenin 122 thuhet: “trashëgimtarë mund të jetë vetëm personi i cili ka lindur i gjallë në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit ose i cili ka qenë i ngjizur gjatë jetës së trashëgimlënësit”.⁸⁸ Fëmijës në këtë rast nuk do t'i njihet

⁸⁷ Дејан Мицковиќ, Постхумната репродукција и наследното право, Zbornik Pravnog fakulteta u Zagrebu, Vol. 61, Br. 2, Zagreb, 2011. Fq.6

⁸⁸ Neni 122, Ligji për trashëgimi i RMV-së.

subjektiviteti juridik në marrëdhëniet trashëgimore pasi ai është ngjizur pas vdekjes së trashëgimlënësit.

Fëmija i lindur nga aplikimi i riprodhimit post-mortem nuk konsiderohet si trashëgimtar për arsye se ngjizja e tij është bërë pas vdekjes së trashëgimlënësit. Mirëpo, ky lloj diskriminimi nuk është i pranueshëm andaj në ligjin për trashëgimi duhet të bëhen ndryshime dhe fëmijëve post-mortem t'u njihet i njëjti status si fëmijet martesor dhe jashtëmartesor. Në rast të vdekjes së burrit reproduktimi post-mortem është i lejuar me pëlqimin e tij paraprak të dhënë në formë të shkruar, më së voni deri në 1 vjet nga vdekja e tij. Nëse aplikohet riprodhimi post-mortem dhe nëse fëmija lind pas vdekjes së burrit (në periudhën më të gjatë se 300 ditë), atëherë ai fëmijë do të ketë status të fëmijës jashtëmartesorë (sipas ligjit për familjen) për shkak të faktit se martesa ka pushuar me vdekjen faktike të njërit nga bashkëshortët. Në këtë situatë, për t'u vërtetuar atësia duhet të zhvillohet procedura për njohjen e atësisë e paraparë me ligjin për familjen. Atësia e fëmijës së lindur jashtë martesës (te reproduktimi post-mortem) mund të pranohet para lindjes së fëmijës. Dua të theksoj se, vërtetimi i atësisë ka rëndësi të veçantë për identitetin e fëmijës dhe për vendosjen e lidhjes juridike midis fëmijës dhe të afërve gjinorë të babait të ndjerë.⁸⁹

Ndërsa analizojmë nëse ligjvënësi duhet të lejojë riprodhimin pas vdekjes duhet të fillojmë nga dy koncepte të cilat janë të përfshira në themelet e sistemeve moderne juridike, koncepti i lirisë riprodhuese dhe koncepti i interesit më të mirë për fëmijën.

Në këtë kontekst duhet të përmendim artikullin e MacKlin, i cili fillon nga tri parimet themelore të moralit perëndimor. Në analizën e tij etike të riprodhimit artificial paraqet disa parime. Si parim të parë paraqet *lirinë individuale* sipas së cilës individët janë të lirë në marrjen e vendimeve dhe veprimeve përderisa këto nuk shkelin të drejtat e të tjerëve. Parimi i dytë është parimi utilitar sipas së cilit moralisht veprimet e drejta janë ato që çojnë në të mirë ose mirëqënie të shumicës njerëzore. Dhe parimi i tretë është ai i drejtësisë, i cili predikon që të gjithë anëtarët e shoqërisë meritojnë qasje të barabartë të mallrat dhe shërbimet që plotësojnë nevojat themelore të njeriut. Nëse marrim parasysh këto parime, duket se duhet të lejohet riprodhimi pas lindjes, sepse siguron respekt ndaj parimit të lirisë individuale të partnerëve, por riprodhimi pas lindjes

⁸⁹Arta – Selmani – Bakiu, Lindja e fëmijës post-mortem. <https://portalb.mk/571909-lindja-e-femijes-post-mortem/>, data e publikimit të shkrimit 21-11-2018, marrë më 15.06.2019

përmbush edhe idealin e parimit utilitar, sepse me lindjen e fëmijës jo vetëm që realizohen interesat e partnerëve, por edhe interesat e fëmijës dhe të shoqërisë. Çështja e të drejtës riprodhuese fillimisht u diskutua seriozisht dhe u rregullua ndërkombëtarisht nga Konferenca Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, e mbajtur në Teheran në vitin 1968. Në këtë Konferencë u miratua e ashtuquajtura "Deklarata e Teheranit", e cila parashikon që prindërit të kenë një të drejtë themelore njerëzore të vendosin lirshëm dhe me përgjegjësi për numrin e fëmijëve të tyre. Ligji i familjes në Maqedoninë e Veriut parashikon: "Në ushtrimin e të drejtës së prindërisë së lirë dhe të përgjegjshme, prindërit janë të detyruar të sigurojnë kushtet optimale për rritjen e shëndetshme dhe zhvillimin e fëmijës së tyre në familje dhe shoqëri ".⁹⁰

⁹⁰ Dejan Mickovic, Angel Ristov. "Biomedical assisted fertilization in Macedonia, Serbia and Croatia: Ethical and legal aspects.

KAPITULLI I TRETË

3.1 E drejta e fëmijës për të njohur prejardhjen biologjike

Në shoqërinë bashkëkohore në dekadat e fundit nuk ekziston një model universal dhe përgjithësisht i pranuar për familjen dhe prindërimin. Pjesë e zhvillimit të përditshëm të shkencës është edhe ndryshimi i vlerave njerëzore i shkaktuar nga inovacioni teknologjik. Nga ky proces i shkencës dhe teknologjisë në të cilën vend primar ka njeriu, lindin shumë dilema etike, morale, filozofike dhe juridike, për të cilat pritet të japë përgjigje shkenca e cila merret me studimin e qënies njerëzore. Në këtë drejtim sigurisht se ka progres edhe në të drejtën familjare bashkëkohore ku përfshihen metodat e reja riprodhuese të cilat ndryshojnë nga procesi natyror i lindjes së fëmijës por nga ana tjetër këto mundësojnë liri më të madhe në planifikimin familjar. Si pjesë e kësaj kthese mbi konceptin e riprodhimit njerëzor diskutohen shumë çështje të rëndësishme etike, morale dhe juridike në lidhje me fshehtësinë e të rriturve si dhe të drejtën e fëmijës për të ditur të vërtetën rreth prejardhjes biologjike.

Siç u theksua edhe më lartë përparimi i teknologjisë në fushën e të drejtës familjare lidhet ngushtë me të drejtën e fëmijës i cili në një periudhë të caktuar të jetës ta hulumtojë identitetin e tij dhe kështu të vërtetojë prejardhjen biologjike.

Riprodhimi artificial qoftë i realizuar edhe në formën më të thjeshtë të mundshme përsëri ngre dilema dhe pikëpyetje të shumta. Duke marrë parasysh të drejtën për riprodhim, çështjet etike të cilat shtrohen për diskutim janë: e drejta e fëmijës për njohjen e identitetit të tij dhe statusi i prindërve.

1) E drejta e fëmijës për njohjen e identitetit të tij. Në rastet e riprodhimit artificial shpeshherë statusi biologjik i fëmijës nuk përputhet me statusin ligjor dhe social të tij, e me këtë vijmë deri te komplikimet për sa i përket identitetit të fëmijës. Çdo kush ka të drejtë të ketë një identitet që nga momenti i lindjes, pra që në fillim identiteti përfshin të dhënat personale të një individi, siç janë: emri dhe mbiemri i familjes, data e lindjes, gjinia, kombësia. Megjithatë identiteti i një personi pasurohet gjatë gjithë jetës, me zgjedhjet që bëjmë prej të cilave disa mund të

ndryshohen, ndërkaq disa të tjera janë të pandryshueshme, të cilat vetëm mund të trashëgohen, që nënkupton atë se individi nuk zgjedh prejardhjen e tij, nuk zgjedh prindërit biologjik. Në këtë aspekt duke shikuar identitetin e fëmijës vijmë në situatë kur fëmijët fillojnë të bëjnë pyetje, si: Kush jam unë? Cila është familja ime e vërtetë apo cilës familje i përkas? Me anë të këtyre pyetjeve mund të themi se fëmijët kërkojnë të njohin identitetin e tyre. Kërkojnë të realizojnë një të drejtë themelore të tyre e cila shpeshherë mbetet një enigmë për arsye të komplikimeve ligjore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

2) *Statusi i prindërve*. Prindërimi është një institut i lashtë po aq sa edhe vetë njerëzimi. Koncepti i tij ka qënë i bazuar në raportin që prindërit kanë me fëmijët e tyre. Prindërit janë konsideruar si dy persona të sekseve të kundërta të lidhur në martesë, të cilët vendosin të riprodhohen dhe të lënë pasardhës, mirëpo realiteti jo gjithmonë është kaq afër ideale. Shumë fëmijë lindin prej prindërve të cilët nuk kanë një lidhje martesore midis tyre dhe në të tjera raste jo gjithmonë dy persona të rritur, për shkak të arsyeve biologjike, mund të riprodhohen dhe të lënë pasardhës. Si rrjedhojë e këtyre zhvillimeve sociale, koncepti i prindërimit ka evoluar në kohë njëkohësisht me evoluimin edhe të lirive dhe të drejtave të njeriut. E drejta për një jetë familjare është e drejta e çdo individi të krijojë familje përmes riprodhimit të tij apo përmes adoptimit. Koncepti i prindërimit ka ndryshuar, nga një koncept tërësisht biologjik, në një koncept sa biologjik edhe ligjor. Kjo e drejtë e fëmijës për të njohur prejardhjen e tij biologjike lidhet me faktin e njohjes së prindërve të tij biologjik dhe të drejtës për të krijuar dhe mbajtur marrëdhënie personale mes tyre nëse kjo është në interes të të dy palëve. Sigurisht se me respektimin e të drejtave të fëmijës përmbushet edhe një ndër kërkesat në fushën e të drejtës familjare e cila është respektimi i dinjitetit njerëzor. E drejta për dinjitetin njerëzor kategorizohet si një e drejtë e patjetërsueshme. Sipas kësaj të drejte çdo qenie njerëzore ka të drejtë në vlera dhe respekt shoqëror si dhe njeriu edhe pas vdekjes është i mbuluar nga mbrojtja e të drejtës për dinjitet. Dinjiteti njerëzor në raport me të drejtën familjare bashkëkohore më së shumti reflekton në institucionin e të drejtës së fëmijës. Gjatë analizimit të këtyre instituteve dhe ndryshimet me aplikimin e metodave të reja riprodhuese, mund të vijë deri te rrezikimi i një kategorie të caktuar personash dhe prandaj përveç të drejtave specifike të fëmijës të garantuara nga konventat ndërkombëtare dhe në veçanti Konventa Evropiane për të Drejtat e Fëmijëve theksohet e drejta e fëmijës për njohjen e

identitetit. Termi identitet interpretohet në disa aspekte siç është aspekti juridik, personal, psikologjik si dhe aspekti sociologjik për të cilat sigurisht se janë dhënë përkufizime specifike.⁹¹ Për më tepër e drejta për të ditur prejardhjen biologjike është një element i rëndësishëm për përcaktimin e identitetit të një personi i cili ka të drejtë të marrë informacione për të vërtetuar të vërtetën në lidhje me prindërit e tij. Një aspekt i rëndësishëm është njohja e fakteve rreth prejardhjes biologjike, mirëpo përveç kësaj me rëndësi është edhe aspekti mjekësor për të mësuar historinë mjekësore të gjithë familjes si dhe informacionin thelbësor që ka të bëjë me gjenetikën e donorëve. Të kuptuarit e origjinës gjenetike sigurisht se ka një rëndësi të veçantë në parandalimin e marrëdhënieve incestuese midis të afërmeve të cilët nuk e dinë që kanë lidhje biologjike.⁹²

E drejta e fëmijës për të njohur prejardhjen biologjike është një e drejtë e garantuar ndërkombëtarisht. Për të arritur standardet më të larta të mbrojtjes juridike të të drejtave dhe lirive të individit, tendenca e ligjit bashkëkohor është të promovojë mbrojtjen e interesit më të mirë të fëmijës. Ky parim është i përfshirë në të gjitha ligjet e vendit dhe dokumentet dhe konventat ndërkombëtare. Pohimi filloi me miratimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Fëmijëve, një dokument që kodifikonte të drejtat dhe interesat e fëmijëve. Një nga shumë të drejta të rëndësishme të promovuara nga kjo Konventë është natyrisht edhe e drejta e fëmijës për të ditur origjinën e tij / e saj. Sipas nenit 7 paragrafit 1 të Konventës: " Fëmija regjistrohet menjëherë pas lindjes dhe me lindje ka të drejtën të ketë emër, të drejtën e kujdesit, shtetësinë dhe, kur është e mundur, (sa të jetë e mundur) të drejtën për të njohur prindërit e tij ose të saj dhe të drejtën për kujdesin e tyre. Korespondent ndaj këtij neni është dispozita e nenit 8, i cili thotë: "Shtetet palë marrin përsipër të respektojnë të drejtën e fëmijës për të ruajtur identitetin e tij, përfshirë këtu edhe shtetësinë, emrin dhe lidhjet familjare ashtu siç njihet me ligj". Kur një fëmijë privohet në mënyrë të paligjshme nga disa ose të gjithë elementët e identitetit të tij ose të saj, shtetet palë do t'i japin ndihmën dhe mbrojtjen e duhur në mënyrë që identiteti i tij ose i saj të

⁹¹ Arta Selmani- Bakiu, Emine Zendeli, Право на детето да го знае своето потекло. In Proceedings of the 3-rd International Scientific Conference- Ohrid School of Law. Effective Protection of the Human Rights and Liberties. Reality or Idea, pp. 231 – 250. [http://www.iuridicaprima.mk/content/files/TOM%205%20finalno%20\(1\)%20\(1\).pdf](http://www.iuridicaprima.mk/content/files/TOM%205%20finalno%20(1)%20(1).pdf), Fq.235

⁹² Po aty.

rikthehet sa më shpejt që të jetë e mundur. E drejta e fëmijës të dijë se kush janë prindërit e tij biologjikë, përcaktohet gjithashtu në nenin 8 të KEDNJ. Kështu, në nenin 7 të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi Të Drejtat e Fëmijës, sanksionohet e drejta e fëmijës për të njohur prindërit e tij, ndërsa në nenin 8 të KEDNJ, sanksionohet e drejta e një personi për të qenë anonim në jetën e tij private, pra me këtë garantohet e drejta e jetës private. Duke analizuar këto dy nene shihet se ekzistojnë mangësi dhe humbet interesi më i lartë i fëmijës, për ta njohur prejardhjen e tij biologjike. Autoriteti publik nuk guxon të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveç nëse ndërhyrja e tillë parashikohet me ligj dhe përbën një masë e cila është në interes të sigurisë kombëtare dhe publike, mirëqenies ekonomike të vendit, parandalimin e krimit, mbrojtjen e shëndetit dhe morali, ose mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve, në një shoqëri demokratike.

E drejta e fëmijës për të njohur origjinën e tij për shumë vite është perceptuar si një e drejtë jetësore dhe si një e drejtë e cila duhet të respektohet, duke marrë parasysh interesin më të mirë të fëmijës. E marrë në përgjithësi, kjo e drejtë e fëmijës nuk është aq shumë e theksuar nëse lind në një familje ku prindërit janë në një martesë të shëndoshë, pasi nga momenti i lindjes nëna dhe babai janë të njohur. Mirëpo, çështja e prejardhjes biologjike është një temë problematike në rastet kur kemi të bëjmë me fëmijët jashtëmartesor, fëmijët e adoptuar si dhe fëmijët e lindur nga ndonjëra nga metodat e inseminimit të ndihmuar biomedicinal. Nga ana tjetër kemi të drejtën për anonimitet të dhuruesit në rastin e fekondimit alogjen i cili qëndron vis a vis me të drejtën e fëmijës për të njohur origjinën e tij gjenetike. Përplasja mes këtyre dy të drejtave gjithmonë hap diskutime edhe në fushën e harmonizimit të ligjeve.

Viteve të fundit, numri i shteteve të cilat në legjislacionin e tyre kanë futur konceptin e zbulimit të së vërtetës dhe të drejtës për të marrë informacione përkatëse mbi origjinën gjenetike është rritur. Nga këndvështrimi historik, kjo e drejtë e fëmijës filloi të garantohet përmes dispozitave kushtetuese dhe ligjore kombëtare në fund të viteve 1980. Të drejtën e fëmijës për ta njohur prejardhjen e tij biologjike, respektivisht fëmijët të cilët kanë qënë të adoptuar. Mbretëria e Bashkuar e ka njohur që nga viti 1975. I rëndësishëm është fakti se shumë vende evropiane miratuan politikën e inicuar nga Suedia në vitin 1984, më pas edhe Austria në vitin 1992, i cili kishte të bëjë me lejimin deri tek informacionet e donatorëve kur fëmija të arrijnë një moshë të caktuar. Kjo vlen edhe në Zvicër (me një ligj të vitit 1998, i cili është në fuqi që nga viti 2001),

për fëmijët e adoptuar që nga viti 2002, duke e parë atë si një të drejtë absolute të fëmijës, Norvegjia nga viti 2003, Hollandën (me një ligj nga viti 2002 mirëpo që është në fuqi që nga viti 2004), Finlanda që nga viti 2006 etj.⁹³

Për legjislacionin modern, por gjithashtu edhe për praktikën juridike çështja se cilës prej situatave duhet t'i jepet përparësi është mjaftë delikate. Prandaj, duke marrë parasysh praktikën juridike krahasuese, në varësi të mënyrës se si ata e kategorizojnë këtë të drejtë të fëmijës dhe dhuruesit, shtetet dallojnë për nga mënyra e zgjedhjes së situatave:⁹⁴

1. Legjislacioni që garanton anonimitetin absolut të dhuruesit të materialit gjenetik dhe i cili përjashton çdo përgjegjësi të dhuruesit ndaj fëmijës është legjislacioni francez, i cili jo vetëm që siguron anonimitetin e donatorit, por gjithashtu garanton që asnjë marrëdhënie prind-fëmijë nuk mund të kërkohet të vendoset midis dhuruesit dhe fëmijës së lindur përmes inseminimit artificial ose ndonjë metode tjetër, pra nuk mund të kërkohet atësia ose amësia e dhuruesit. Duhet gjithashtu të theksohet se legjislacioni francez garanton të drejtën e nënës që të mbetet anonim gjatë lindjes dhe të mos regjistrohet në regjistër të lindjes si nëna e fëmijës (kjo vërehet në rastin *Oddiyevre - v. France-Odièvre* të cilin do ta shtjelloj më poshtë punimit). Përveç se në Francë, e drejta për lindje anonime të nënave është e garantuar edhe në Republikën Çeke, Itali dhe Luksemburg.

2. Shtetet të cilat përmes ligjeve të tyre parashikojnë një anonimitet të përgjithshëm dhe relativ të donatorëve. Për shembull, në Spanjë lejohet që një fëmijë të informohet për dhuruesin, por jo për identitetin e tij / saj, dhe vetëm kur një informacion i tillë është i nevojshëm për shëndetin e fëmijës.

⁹³ Arta Selmani- Bakiu, Emine Zendeli, Право на детето да го знае своето потекло. In Proceedings of the 3-rd International Scientific Conference- Ohrid School of Law. Effective Protection of the Human Rights and Liberties. Reality or Idea, pp. 231 – 250. [http://www.iuridicaprima.mk/content/files/TOM%205%20finalno%20\(1\)%20\(1\).pdf](http://www.iuridicaprima.mk/content/files/TOM%205%20finalno%20(1)%20(1).pdf), fq.240

⁹⁴ Arta Selmani- Bakiu, Emine Zendeli, Право на детето да го знае своето потекло. In Proceedings of the 3-rd International Scientific Conference- Ohrid School of Law. Effective Protection of the Human Rights and Liberties. Reality or Idea, pp. 231 – 250. [http://www.iuridicaprima.mk/content/files/TOM%205%20finalno%20\(1\)%20\(1\).pdf](http://www.iuridicaprima.mk/content/files/TOM%205%20finalno%20(1)%20(1).pdf), fq.240-241

3. Legjislacione sipas së cilave mund të merren informacione rreth identitetit të donorit, mirëpo kjo nuk e detyron në përgjegjësi prindërore. Sipas ligjit Suedez fëmija e fiton këtë të drejtë me arritjen e moshës madhore ndërsa sipas ligjit austriak me mbushjen e moshës 14 vjeçare.

4. Legjislacioni i cili njih të drejtën e fëmijës për të njohur prejardhjen biologjike respektivisht njohjen e dhuruesit, por edhe të drejtën për të filluar një procedurë për vendosjen e atësisë së dhuruesit. Kjo e drejtë nuk pranohet si e drejtë absolute, përveç në situatat kur atësia e burrit të nënës me të cilën jeton fëmija nuk mund të konstatohet.⁹⁵

Siç mund të shihet, në legjislacionin e Evropës këto të drejta nuk rregullohen njësoj. Kjo do të thotë që e drejta e fëmijës për të njohur origjinën biologjike në arenën evropiane nuk është e natyrës imperative. Por duke pasur parasysh të drejtat dhe interesat e prindërve ose të dhuruesit, koncepti mbizotërues duhet të jetë interesi më i mirë i fëmijës. E drejta e fëmijës për të njohur origjinën e tij ose të saj duhet të trajtohet si një e drejtë absolute dhe themelore e njeriut. Vetëm në këtë mënyrë fëmija do të faktorizohet si subjekt i vërtetë i ligjit i cili është një kërkesë themelore e Konventës Evropiane për të Drejtat e Fëmijës.⁹⁶

Mund të shohim se edhe në legjislacionin tonë ekzistojnë kontradikta për sa i përket të drejtës së fëmijës rreth njohjes biologjike. Kështu, nëse shohim ligjin për familjen në vendin tonë, thuhet se pas themelimit të adoptimit të plotë në librin amë të të lindurve, si prindër të fëmijës shënohen adoptuesit, ndërsa si vend i lindjes së fëmijës shënohet vendi të cilin me marrëveshje e caktojnë adoptuesit.⁹⁷ Adoptuesit konsiderohen prindër të të adoptuarit që në kohën e lindjes së tyre. Nga ana tjetër me faktin se të dhënat për adoptimet e themeluara janë sekret zyrtar⁹⁸ fëmija pengohet që të marrë të dhëna në lidhje me prindërit e tij biologjik. Nga këndvështrimi i mbrojtjes të së drejtave, ligji i familjes mbron të drejtën e anonimitetit të prindërve biologjikë dhe faktin e adoptimit, d.m.th. u jep përparësi të drejtave të prindërve. Kështu, ligji ynë nuk mbron të drejtën e fëmijës së adoptuar për të marrë informacion në lidhje

⁹⁵ Arta Selmani- Bakiu, Emine Zendeli, Право на детето да го знае своето потекло. In Proceedings of the 3-rd International Scientific Conference- Ohrid School of Law. Effective Protection of the Human Rights and Liberties. Reality or Idea, pp. 231 – 250. [http://www.iuridicaprima.mk/content/files/TOM%205%20finalno%20\(1\)%20\(1\).pdf](http://www.iuridicaprima.mk/content/files/TOM%205%20finalno%20(1)%20(1).pdf), fq.240-241

⁹⁶ Po aty

⁹⁷ Ligji për Familjen neni 111 par.1, tekst i konsoliduar, 6/25/2019

⁹⁸ Ligji për Familjen neni 123 – a, tekst i konsoliduar, 6/25/2019

me prindërit e tij ose të saj biologjikë ashtu siç garantohet me nenin 7 paragrafi 1 të KDF-së. Kjo dispozitë ligjore është gjithashtu në kundërshtim me nenin 22 paragrafi. 3 të Konventës Evropiane për Adoptimin e Fëmijëve, e cila garanton të drejtën e fëmijës për të marrë informacione mbi origjinën e tij / saj. Gjithashtu, sipas nenit 77 të LF-së nuk lejohet vërtetimi ose mohimi i amësisë dhe atësisë në rastin kur marrëdhënia prindërore është krijuar me adoptim, që d.m.th se ky koncept e cënon interesin më të lartë të fëmijës dhe që duhet të kritikohet. Sipas ligjit për familjen, personi i adoptuar nuk ka të drejtë edhe për një marrëdhënie të mirëfilltë shoqërore me prindërit biologjikë, e drejta e tij për t'u kujdesur dhe prindërimi përmbushet nga prindërit adoptues. Sidoqoftë, atij nuk duhet t'i mohohet informacioni që i nevojitet për të marrë një pamje të qëndrueshme rreth origjinës dhe të ketë një shpjegim të qartë se si erdhi në këtë botë. Nga ana tjetër, prindërit kujdestar nuk kanë asnjë detyrim ligjor t'i zbulojnë informacionin fëmijës në lidhje me adoptimin dhe origjinën e tij. Por praktika tregon që fëmija, pas një kohe të caktuar, mëson të vërtetën për prindërit e tij biologjikë.⁹⁹

3.2 Raste nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut mbi mbrojtjen e të drejtës së identitetit

Një e drejtë themelore e cila është e mbrojtur nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut është garantimi i respektimit të jetës private dhe familjare.

Në nenin 8 të Konventës Evropiane mbrohet e drejta e çdokujt për respektimin e jetës private dhe familjare. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri

⁹⁹ Arta Selmani- Bakiu, Emine Zendeli, Право на детето да го знае своето потекло. In Proceedings of the 3-rd International Scientific Conference- Ohrid School of Law. Effective Protection of the Human Rights and Liberties. Reality or Idea, pp. 231 – 250. [http://www.iuridicaprime.mk/content/files/TOM%205%20finalno%20\(1\)%20\(1\).pdf](http://www.iuridicaprime.mk/content/files/TOM%205%20finalno%20(1)%20(1).pdf), fq.247

demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve.¹⁰⁰

Në praktikën juridike të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut hasim raste të ndryshme mbi mbrojtjen e të drejtës së identitetit. Në marrëdhënie me dokumentat e tjera ndërkombëtare, Konventa Evropiane për të Drejtat e Fëmijëve dallohet nga të tjerat për arsye se përmban një sistem të veçantë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.

Si është bërë vlerësimi nga gjykata në lidhje me shkeljen e nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Një shembull të tillë hasim te rasti *Mizzi*. Aplikanti ishte një biznesmen i njohur në Maltë. Në vitin 1996 gruaja e tij X mbeti shtatzane mirëpo gjatë shtatzanisë ata u ndanë dhe pas ndarjes gruaja lindi një vajzë Y. Aplikanti u konsiderua automatikisht si babai i vajzës dhe ky i cili ishte parashtruesi i kërkesës u përpoq për të ngritur procedurë për kundërshtimin e atësisë. Sipas Kodit Civil të Maltës, një burrë mund të sfidojë atësinë nëse ai dëshmon tradhëtinë bashkëshortore të gruas së tij dhe nëse lindja e foshnjës ishte fshehur prej tij. Ky kusht i fundit u rrezua me ndryshimin e ligjit në v.1993 dhe koha e limituar prej 6 muajsh prej ditës së lindjes së fëmijës ishte si një pikë e prerë prej kur mund të fillonin procedura të tilla. Në maj të vitit 1997, Gjykata Civile pranoi kërkesën e paditësit për deklaratën e cila pavarësisht nga depozitat e Kodit Civil, ai kishte të drejtë të procedonte me një veprim atëror dhe konstatoi se kishte pasur shkelje të nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ky gjykim u revokua më pas nga Gjykata Kushtetuese. Paditësi u ankua për arsye se atij iu mohua hyrja në gjykatë dhe se prezumimi i pakundërshtueshëm i atësisë i aplikuar në rastin e tij ishte një ndërhyrje joproporcionale me të drejtën e tij për respektimin e jetës private dhe familjare. Ai gjithashtu u ankua se vuajti diskriminim, sepse palët e tjera me interes për të vendosur atësinë në këtë rast nuk i nënshtroheshin të njëjtave kushte dhe afate të rrepta. Ai u mbështet në nenin 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare), nenit 6 (qasja në gjykatë) dhe neni 14 (ndalimi i diskriminimit). Pra përfundimisht aplikanti u ankua se legjislacioni Maltez e ka diskriminuar atë në bazë të statusit si një baba i supozuar, duke imponuar kështu një afat kohor që vlente mbi burrat që heqin dorë nga e drejta prindërore, mirëpo kjo nuk është e zbatueshme për fëmijën apo nënën. Gjykata ishte e mendimit se fakti që paditësit asnjëherë nuk i ishte lejuar që të mohonte

¹⁰⁰ The European Convention on Human Rights, 4.11.1950, http://www.echr.coe.int/Documents/Convention_ENG.pdf, marrë më 10.06.2019

atësinë nuk ishte proporcional me qëllimet legjitime të ndjekura. Baraspesha e gjetur mes interesit të përgjithshëm të mbrojtjes së sigurisë juridike të marrëdhënieve familjare dhe atij të paditësit nuk kishte qenë e drejtë.¹⁰¹

Gjithmonë duke marrë parasysh interesin më të lartë të fëmijës dhe lejimin për njohjen e identitetit në këtë rast paditësi nuk ka të drejtë për arsye se nëse ishte aprovuar kërkesa për kundërshtim të atësisë atëherë nuk do të mbrohej interesi më i mirë për fëmijën.

Rasti Gaskin, filloi nga një kërkesë kundër Mbretërisë së Bashkuar e paraqitur pranë Komisionit në bazë të nenit 25 nga Z. Graham Gaskin, një qytetar britanik i cili lindi në 2 dhjetor 1959. Pas vdekjes së nënës së tij, ai u mor në përkujdesje nga Këshilli i Qytetit të Liverpoollit, më 17 shkurt 1983. Gjatë pjesës më të madhe të periudhës kur ai ishte në kujdes, aplikanti u konviktua me prindër të tjerë kujdestarë, duke iu nënshtruar dispozitave të rregulloreve për konviktin e fëmijëve 1955. Sipas kushteve të këtyre rregulloreve, autoriteti vendor kishte për detyrë të mbante të dhëna konfidenciale në lidhje me aplikantin dhe kujdesin e tij. Aplikuesi pretendon se gjatë përkujdesjes ishte keqtrajtuar, dhe ka dëshiruar të marrë detaje se ku është mbajtur dhe nga kush dhe në cilat kushte në mënyrë që të mësojë rreth të kaluarës së tij. Më 9 tetor 1978, aplikanti u lejua nga një punonjës social në punësimin e Këshillit të Qytetit të Liverpoollit për të parë të dhënat e çështjeve në lidhje me të kaluarën e tij të mbajtura nga Departamenti i Shërbimeve Sociale të Këshillit. Ai i hoqi ato regjistrime pa pëlqimin e Këshillit, duke i mbajtur në zotërimin e tij derisa i ktheu në Departamentin e Shërbimeve Sociale. Në këtë rast gjykata si parim kryesor e vlerësoi parimin udhëheqës për qasjen në informata rreth prejardhjes biologjike: çdo person si qenie njerëzore individuale ka mundësinë e zbulimit të identitetit të tij. Ky rast u paraqit nga paditësi për të ditur prejardhjen dhe ishte nisur nga dëshira e tij për hapjen e procedurës kundër autoritetit lokal për dëmet nga neglizhenca në lidhje me keqtrajtimin që e kishte përjetuar gjatë kohës sa ishte nën kujdesin publik. Kërkesa e tij ishte hedhur poshtë pasi zbulimi i të dhënave në periudhën kur ai ishte nën kujdes konsideroheshin private dhe konfidenciale. Pas konfirmimit të vendimit u miratua një rezolutë nga autoritetet kompetente sipas së cilës informatat në dosjen e paditësit do të duhej që t'i jepen nëse kontribuesit e dosjes

¹⁰¹European Court of Human Rights

[https://hudoc.echr.coe.int/eng-press?i=003-1551378-1623734#{%22itemid%22:\[%22003-1551378-1623734%22\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng-press?i=003-1551378-1623734#{%22itemid%22:[%22003-1551378-1623734%22]}), marrë më 12.06.2019

do ta kishin lejuar, mirëpo kjo nuk ndodhi pasi ata e kishin refuzuar. Përfundimisht Gjykata vërtetoi se personat të cilët ishin në rastin e paditësit mbrohen nga Konventa dhe kanë të drejtë të marrin informacione në lidhje me prejardhjen e tyre dhe për të zbuluar identitetin. Edhe pse e drejta për qasje në nenin 8 nuk është absolute në rastin Gaskin, Gjykata vendosi në favor të paditësit pasi vërtetoi se ishte rrezikuar interesi i qytetarit.¹⁰²

Në këtë rast është bërë shkelja e nenit 8 të KEDNJ dhe gjykata ka vendosur në interes të paditësit, me çka mbrohet e drejta për prejardhjen biologjike. *Rasti Odièvre*, filloi nga një kërkesë kundër Republikës Franceze të paraqitur pranë Komisionit Evropian të të Drejtave të Njeriut nga një shtetase franceze me emrin Pascale Odièvre. Aplikuesi pretendoi se për arsye që lindja e saj ishte mbajtur e fshehtë dhe se ishte e pamundur për të që të zbulonte origjinën e saj, ishte një shkelje e të drejtave të saj të garantuara me nenin 8 të Konventës dhe diskriminim në kundërshtim me nenin 14. Gjykata kishte kërkuar që të hulumtonte rregullat për konfidencialitet në kohën e lindjes, që ia kishin pamundësuar paditëses, e cila ishte e vendosur nën kujdesin publik për shkak të dëshirës së nënës së saj pasi nëna e saj kërkoi që lindja të mbahej e fshehtë me çka kishte plotësuar edhe një formular në Departamentin e Shëndetit dhe Sigurimit Social, duke e braktisur atë. Shumë më vonë arriti të sigurojë informacione jo identifikuese për familjen e saj natyrale dhe pasi ajo kishte kuptuar që kishte vëllezër natyralë, kishte bërë kërkesë për zbulimin e informatave konfidenciale lidhur me lindjen e saj dhe të ketë leje për marrjen e kopjeve të çfarëdo dokumenti çoftë kjo edhe certifikata e plotë e lindjes. Paditësja nuk mund të merrte informata pasi sipas ligjit të vendit, kërkesa e paraqitur për zbulimin e informacionit rreth identifikimit të nënës së saj ishte e papranueshme nëse konfidencialiteti ishte dakorduar në lindje. Në këtë rast dhe me këtë lloj kërkesë gjykata ishte e ballafaquar për herë të parë, dhe i duhej që të barazonte një numër interesash konkurruese. Gjykata theksoi se edhe pse shumica e vendeve të cilat kishin nënshkruar Konventën nuk kishin një legjislacion të njëjtë me atë të cilin zbatohet në Francë, i cili e ndalonte përgjithmonë lidhjen prindërore mes nënës natyrore dhe fëmijës së lindur nëse ajo e kishte refuzuar që të zbulohet identiteti i saj, disa prej shteteve nuk shqiptonin asnjë detyrim mbi prindërit natyror për të deklaruar identitetin e tyre, me këtë ekzistonin edhe raste kur ishin braktis fëmijët të cilët ishin lindur në mënyrë anonime. Në

¹⁰² European Court of Human Rights
<https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-57491%22%5D%7D>, marrë më 13.06.2019

sistemet juridike të shteteve të ndryshme ekzistonte llojllojshmëria e praktikave të cilat zbatoheshin poashtu edhe fakti se fëmijët po braktiseshin, e me këtë Gjykata mendoi se shteteve duhet që t'u jepet një margjinë e vlerësimit që të vendosur se cilat masa ishin të duhura për të siguruar të drejtat e garantuara nga Konventa. Paditësja në këtë rast kishte pasur qasje në të dhëna joidentifikuese për nënën e saj dhe familjen natyrore, për këtë arsye Gjykata gjithashtu kishte vërtetuar se kërkesa e paditëses nuk ishte hedhur poshtë plotësisht duke siguruar me këtë mbrojtjen e interesave të palëve të treta. Gjithashtu, ishte me rëndësi edhe aspekti respektimit të ligjit nacional, i cili mbronte të drejtën e nënave për lindje në mënyrë anonime, me caktimin e një këshilli nacional mund të kishin qasje në informata rreth prejardhjes personale, përmes këtij paditësja do të mund që të kërkonte zbulimin e identitetit të nënës së saj. Gjykata ishte mjaft e kënaqur që legjislacioni francez kërkonte që të arrijë në një baraspeshë dhe të sigurojë një proporcion të mjaftueshëm mes interesave të shteteve të ndryshme duke përfshirë edhe Konventat. Meqë nuk u gjet shkelje të nenit 8, Gjykata theksoi se Franca nuk mund të thuhet se ka tejkaluar margjinën e vlerësimit, e cila është dashur që t'i jepej duke marrë parasysh natyrën e ndërlikuar dhe të ndjeshme të çështjes dhe qasjes në informata rreth prejardhjes, çështje që ka të bëjë me të drejtën për të ditur historinë personale, zgjedhjen e prindërve natyror, lidhjet ekzistuese familjare dhe prindërit adoptues.¹⁰³

Ky legjislacion garanton anonimitet absolut të dhuruesit të materialit gjenetik i cili përjashton çdo përgjegjësi të dhuruesit ndaj fëmijës, mirëpo përsëri kërkesa e paditëses nuk u hodh poshtë dhe në një mënyrë jo të plotë u bë respektimi i të drejtës për njohjen e identitetit familjar.

¹⁰³European Court of Human Rights
<https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-60935%22%5D%7D>, marrë më 14.06.2019

3.3 Kufizime të përgjithshme për persona të caktuar që kanë të drejtë akses në metodat e reja riprodhuese

Duke pasur parasysh mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës dhe duke mos dëmtuar të ardhmen e familjes gjithmonë duhet pasur parasysh një kriter, i cili është kufizimi në aksesin e këtyre teknikave për riprodhim artificial për persona të caktuar.

Si kufizim përmendet *statusi martesor*, disa legjislacione nuk u lejojnë akses në këto metoda personave të cilët nuk gëzojnë statusin martesor. Figura ideale në të cilën është pasqyruar familja ka qënë një burrë dhe një grua, të lidhur në martesë me njëri tjetrin dhe të cilët e kurorëzojnë dashurinë e tyre me ardhjen në jetë të një fëmije. Pra sipas ligjit për familje martesa është bashkësi jetësore e burrit dhe gruas e rregulluar me ligj, në të cilën realizohen interesat e bashkëshortëve, familjes dhe shoqërisë. Marrëdhëniet midis bashkëshortëve krijohen mbi vendimin e lirë të burrit dhe gruas që të lidhin martesë, mbi barazinë e tyre, respektimin e ndërsjellë dhe ndihmën reciproke.¹⁰⁴ Mirëpo, kjo figurë ideale tashmë ka ndryshuar konceptin, sot gra të shumta mund t'i shohim të vetme duke pasur fëmijë, disa të tjera për shkak të martesave jo të lumtura mund të jenë të dala nga martesa. Shumica e të cilëve janë kundër aplikimit të këtyre metodave mendojnë se ky kufizim duhet të bëhet për shkak të dëmit emocional dhe psikologjik që mund t'u shkaktohet fëmijëve. Edhe pse ndonjëherë fëmijët të cilët jetojnë vetëm me njërin nga prindërit mund të kenë një jetesë më të mirë.

Akses në këto metoda poashtu kërkojnë edhe *homoseksualët* pasi që e drejta për riprodhim nuk është e lidhur me drejtimin seksual të çdo personi, mirëpo nga ana tjetër shtrohet pyetja se a do të çenohet e drejta e fëmijës, apo si do ta shoh shoqëria këtë fëmijë, pra kjo nuk mbron interesin më të lartë të fëmijës. Personat të cilët i drejtohen këtyre metodave kanë shpeshherë probleme me infertilitetin dhe të njëjtën nuk mund ta themi për çiftet homoseksuale, mirëpo për shkak të mungesës së partnerit me gjini të kundërt ata kërkojnë aplikimin e këtyre metodave.

¹⁰⁴ Neni 6, Ligji për Familje

Gjithmonë kemi hasur se qëllimi i homoseksualëve është që të bindin ligjvënësit që ata të mos diskriminohen për shkak të orientimit seksual si dhe mbrojnë faktin se kjo formë e krijimit të familjes është poashtu produktive siç janë edhe format e tjera. Edhe pse disa vende evropiane homoseksualëve u lejojnë që të kenë akses në metodat e riprodhimit artificial, ende ekzistojnë vende të cilat nuk ua lejojnë homoseksualëve këtë duke e justifikuar me atë se do të dëmtohet instituti i familjes dhe poashtu marrin parasysh edhe interesin më të lartë të fëmijës. Për shkak të kufizimeve që u bëhen homoseksualëve ata mund të përfshihen në martesë të cilat janë të simuluar vetëm që të kenë fëmijë ose mund të shpërngulen nëpër vende të tjera të cilat janë më liberale, duke arritur kështu ndoshta në probleme më të mëdha.

Duke marrë parasysh rolin që kanë prindërit në mirëritjen e fëmijës, një shqetësim tjetër që vlen të theksohet është *mosha*, dhe kjo për të vetmen arsye se jo çdo kush duhet të ketë akses në këto metoda. Grupmoshat e caktuara të cilat ngrejnë diskutime morale, etike dhe ligjore janë femrat në moshën e menopauzës si dhe femrat në kohën e adoleshencës. Duke e ditur faktin se menopauza është një “alarm psikologjik” me anë të së cilit kuptohet se mundësia e një femre për t’u riprodhuar në mënyrë natyrore mbaron, atëherë kjo nuk mund të jetë ndryshe edhe në mirëritjen e atij fëmije pasi prindëria është një marrëdhënie e qëndrueshme në kohë dhe përkujdesi duhet të ekzistojë deri në një moshë ku fëmija të mund të jetë i pavarur e nëse prindi e merr këtë status në një moshë kaq të madhe atëherë rreziku bie mbi fëmijën i cili mund të mbetet jetim pa arritur moshën madhore. Nga ana tjetër kemi edhe femrat në kohën e adoleshencës, shqetësimi që vjen në këtë rast ka të bëjë me atë se kjo moshë është më pak e përgjegjshme në krahasim me grupmoshat e tjera dhe kjo e bën kërcënuese faktin e mirëritjes së fëmijës. Sa e aftë do të jetë kjo nënë të rrisë fëmijën dhe të jetë e përkushtuar maksimalisht për të?

Shpeshherë duke u bazuar në ligjin për inseminimin e ndihmuar biomedicinal do të vërejmë disa ndalesa për sa i përket aplikimit të inseminimit artificial:

- Ndalohet që spermatozoidet e dhuruar të shfrytëzohen për fekundim, nëse donatori dhe femra të cilat kryhet INB-ja alogjene janë në lidhje farefisnore, përkatësisht ndërmjet të cilëve nuk lejohet lidhja e martesës. Ndalohet që qelizat vezë të dhuruara të fekondohen me spermatozoide të mashkullit, të cilit për shkak të lidhjes farefisnore nuk i lejohet lidhja e martesës me donatorin. Ndalohet që embrioni i dhuruar të shfrytëzohet për fekundimin e femrës, e cila për shkak të lidhjes farefisnore nuk mundet me donatorin e

spermatozoideve prej të cilëve është krijuar embrioni të lidhë martesë, as për fekondimin e femrës që është në lidhje farefisnore në vijë të drejtë me femrën nga qeliza vezë e së cilës është krijuar embrioni.¹⁰⁵

- Ndalohet shfrytëzimi i kësaj procedure me qëllim të zgjedhjes së gjinisë së fëmijës së ardhshëm, përveç evitimit të sëmundjes së rëndë trashëguese të lidhur me gjininë.¹⁰⁶
- Ndalesë tjetër dhe shumë e rëndësishme është gjithashtu përzierja e qelizave gjinore mashkullore përkatësisht femërore, të krijuara nga spermatozoidet e dy apo më tepër meshkujve, ose qelizat vezë të dy apo më tepër femrave.¹⁰⁷
- Ndalohet tregtia me qelizat gjinore dhe embrionet. Ndalohet botimi i shpalljes publike, me ndërmjetësimin e medimeve publike, ose në çfarëdo mënyre tjetër të kërkohen apo ofrohen qeliza gjinore ose embrione.¹⁰⁸
- Ndalohet që nëpërmjet shpalljes publike, medieve publike apo në çfarëdo mënyre tjetër të kërkohet apo ofrohet shërbim i lindjes së fëmijës për tjetër. Ndalohet blerja, dhënia apo pranimi i ofertës për blerje apo reklamim të blerjes së embrionit in vitro. Ndalohet shitja, dhënia apo pranimi i ofertës për shitjen apo reklamimin e shitjes së embrionit in vitro. Ndalohet themelimi i shoqërisë tregtare, veprimtaria e së cilës është ndërmjetësimi në gjetjen e femrave që duan të jenë bartëse të shtatzënisë.¹⁰⁹
- Ndalohet klonimi pra çdo procedurë e dedikuar për krijimin e qenies njerëzore, gjenetikisht identike njëjtë me qenien tjetër njerëzore, qoftë të gjallë apo të vdekur.¹¹⁰

Në procedurën e inseminimit të ndihmuar biomedicinal, ndalohet që:¹¹¹

1) të mundësohet zhvillimi jashtë trupit i embrionit që është më i vjetër se 14 ditë, përkatësisht pas zhvillimit të rrudhës parake;

¹⁰⁵ Neni 22, Ligji për inseminim të ndihmuar biomedicinal, tekst i konsoliduar 6/25/2019

¹⁰⁶ Neni 24, po aty.

¹⁰⁷ Neni 25, po aty.

¹⁰⁸ Neni 26, po aty.

¹⁰⁹ Neni 27, Ligji për inseminim të ndihmuar biomedicinal, tekst i konsoliduar 6/25/2019.

¹¹⁰ Neni 28, po aty.

¹¹¹ Neni 29, po aty.

2) të fekondohet qeliza vezë njerëzore me spermatozoidin e kafshës ose qeliza vezë shtazore me spermatozoidin e burrit, ose të ndryshohet embrioni me transplatimin e pjesëve të embrioneve të tjera njerëzore apo shtazore (mundësia për t'u krijuar hibridi ose himera);

3) të futen qelizat gjinore njerëzore ose embrionet njerëzore te kafsha dhe

4) të futen qelizat gjinore shtazore ose embrioni shtazor te gruaja.

Ndalohet që të krijohen embrione njerëzore për qëllime hulumtimi si dhe përzierja e përmbajtjes qelizore nga dy femra.¹¹²

¹¹² Neni 29, po aty.

3.4 Anketë

Ky pyetësor është pjesë përbërëse e punimit shkencor *“Prindëria e themeluar me anë të inseminimit artificial. E drejta dhe liria riproduktive”*. Një ndër qëllimet më të rëndësishme të këtij hulumtimi është edhe mbledhja e të dhënave nga shoqëria jonë për të arritur në përfundimin se sa është i pranueshëm aksesimi në teknikat e reja riproduktive. Ky punim është i një rëndësie të veçantë dhe është punim i parë i magistraturës në gjuhën shqipe. Pasi aplikimi i metodave të riprodhimit dhe zhvillimi i shpejtë i tyre e ka vendosur përpara një sfidë institutin e prindërisë është e nevojshme të përcaktohet nëse zhvillimi i një shoqërie dhe evolimi i tillë i konceptit të riprodhimit dhe prindërisë është i pranueshëm nga normat etike dhe morale.

Nga anketa e realizuar janë të përfshirë një numër i madh i ligjëruesve në rrethinën e Strugës, familjarë si dhe studentë nga UEJL-ja dhe UT-ja. Nga të gjitha përgjigjet në anketë është arritur në një përfundim se si mendojnë një grup i vogël i shoqërisë në lidhje me këto metoda.

1. A jeni të njohur me të gjitha teknikat e reja riproduktive të cilat janë të lejuara në legjisllacionin e vendit tonë ?

Nga personat e anketuar vetëm 20% e tyre ishin të njohur me të gjitha teknikat e reja riproduktive, ndërsa pjesa tjetër e tyre shumë pak dinin për to, madje disa nga teknikat ishin edhe të pa dëgjura.

2. A mendoni se liria riproduktive e çënon interesin më të lartë të fëmijës? (si psh. familjet monoprindeore, reproduksioni post mortem, familjet homoseksuale etj)

60% mendonin se liria riproduktive nuk e çënon interesin më të lartë të fëmijës duke e arsytuar në përgjithësi me faktin se shpeshherë hasen fëmijë në familje monoprindeore dhe që janë familje të shëndosha, poashtu arsytetohet me faktin se interesi më i lartë i fëmijës është që të lind, të vijë në këtë botë dhe të ekzistojë.

40% e tyre mendonin se në këtë rast çënohet ineteresi me i lartë i fëmijës për arsye se me aplikimin e disa teknikave atyre u humbej e drejta për të jetuar me dy prindër dhe me këtë humbej edhe koncepti i familjes tradicionale

3. Si e shihni krijimin e familjes nga një grua e vetme e cila nuk dëshiron që të krijoj familje me anë të një partneri mashkull por që me anë të in vitro procesit me material gjenetik të donuar të lind fëmijë dhe të krijon një familje mono prindërore?

70% ishin kundër për arsye se mbronin konceptin tradicional të familjes dhe për këtë duhen që të dy prindërit dhe poashtu kjo për mentalitetin tonë shihet si diçka absurde. Një pikpyetje e madhe që shtrohej këtu ishte fakti se si do t'ia shpjegojë kjo nënë konceptin e familjes fëmijës së vet duke u rrethuar në përgjithësi nga familjet me dy prindër.

30% ishin pro kësaj duke e arsyetuar me faktin se çdokush është i lirë të vendos rreth jetës të cilën do ta jetojë.

4. A mendoni se zhvillimi i shpejtë i bioteknologjisë dhe mjeksisë riprodhuese si dhe aplikimi i këtyre metodave shpien deri në fragmentimin e konceptit të prindërimit dhe familjes në përgjithësi?

60% mendonin se zhvillimi i shpejtë i bioteknologjisë dhe mjeksisë riprodhuese si dhe aplikimi i këtyre metodave shpien deri në fragmentimin e konceptit të prindërimit dhe familjes, mirëpo shumica mendonte nëse kjo merr përmasa akoma më të mëdha duke u përdorur edhe disa nga metodat të cilat ende këtu në legjislacionin e vendit tonë janë të ndaluara.

40% zhvillimin e bioteknologjisë e shihnin si diçka pozitive pasi me këtë zgjidheshin problemet në lidhje me infertilitetin

5. A mendoni se këto medota duhet të jenë plotësisht të pranueshme pasi zgjidhen problemet në lidhje me infertilitetin?

60 % mendojnë se nuk duhet të jenë plotësisht të pranueshme

40% ishin pro kësaj

6. Si do të pranohet në shoqëri por edhe në familje fëmija i cili për 9 muaj është mbajtur nga nëna surrogate? (me surrogacion nënkuptojmë procesin e mbajtjes dhe lindjes së fëmijës për tjetrin, në bazë të një marrëveshje paraprake nga të dy palët: gruas mbajtëse/ nëna surrogate dhe prindërve juridik/ çiftit porositës)

70% prej tyre mendonin se kjo është një akt human pasi së fundi fëmija do të rritet në familjen biologjike.

30% e shihnin këtë problematike për arsye se këtu ndërlihen çështje etike, psikologjike dhe problemet e mentalitetit të shoqërisë sonë për ta pranuar një mënyrë riprodutive të këtij lloji për zgjerimin e familjes.

7. A mendoni se një person duhet të ketë të drejtën absolute të bëhet prind dhe a është liria riprodhuese e njeriut aq e gjërë sa që ai ka të drejtë të bëhet prind edhe pas vdekjes (reproduksioni post mortem) , duke përdorur teknikat e inseminimit artificial ose fekondimit in vitro?

40% mendonin se dashuria është motivi kryesor i cili i arsyeton të gjitha problemet dhe pse mos lindi fëmija i cili simbolizon frutin e dashurisë nga dy prindër ndonëse njëri nuk do të ekzistojë gjatë rritjes së fëmijës

60% ishin kundër kësaj, disa e arsyetuan me faktin se prindërimi duhet të shijohet, poashtu edhe fëmija duhet t'i ketë të dy prindërit e tij

8. Për arsye se në legjislacionin tonë kemi mosharmonizim ndërmjet ligjeve, a mendoni ju se fëmija duhet të dijë prejardhjen e tij biologjike apo kjo duhet të mbetet një sekret zyrtar duke mos u zbuluar se kush është donori ?

Mendimi i shumicës ishte në mbrojtje të interesit të fëmijës me arsyetimin se cdo kush duhet të dijë prejardhjen e vet biologjike, çoftë kjo për arsye shëndetësore apo thjesht për ta njohur familjen e vet biologjike.

9. Edhe pse në legjislacionin e vendit tonë ndalohej, a do ta pranoni një familje me prindër të gjinisë së njëjtë?

90% - jo

10% - po

10. A mendoni se kufizimi në aksesin e këtyre teknikave për persona të caktuar (një grua beqare, gratë pas menopauzës, homoseksualët) do të paraqes mbrojtje më të lartë të interesit të fëmijës dhe nuk do të dëmtojë të ardhmen e familjes?

20 % - jo

80% - po

Për realizimin e këtij hulumtimi u intervistuan edhe dy gjinekolog nga rrethina e Strugës, me çka arrita në një përfundim se si ata i udhëzojnë çiftet të cilët kanë probleme në riprodhim.

Fillimisht ata e konsideruan ardhjen në jetë të një fëmije një ndër kënaqësitë më të mëdha në jetën e një çifti ashtu siç të gjithë mendojnë. Mirëpo, për shkak të disa faktorëve, steriliteti apo pamundësia për të patur pasardhës rritet, duke ndikuar kështu martesat në moshë të madhe, përdorimi i alkoolit, duhanit, obeziteti si dhe sëmundjet seksualisht të transmetueshme.

Gjatë eksperiencës së tyre ata kishin hasur raste nga më të ndryshmet mirëpo ajo çka është e vërtetuar ka të bëjë me atë se kur çifti pas një viti të marrëdhënieve të rregullta seksuale dhe të pambrojtur nga mjetet kontraceptive nuk mund që të lind pasardhës kemi të bëjmë me sterilitet i cili mund të jetë me origjinë nga gruaja, burri ose i përbashkët.

Fillimisht kur çiftet paraqiten në gjinekologji ata u rekomandojmë të bëjnë edhe një konsultë te andrologu dhe një analizë të spermës, mirëpo në vendin tonë burrat e kanë shumë të vështirë të vizitohen dhe të mjekohen dhe në shumicën e rasteve mendojnë se problemi

gjithmonë qëndron te femrat. Mirëpo, ekzaminimi është i domosdoshëm për të dy partnerët, testet të cilat bëhen zgjasin disa muaj pasi sistemi riprodhues është shumë i ndërlikuar. Ekziston mundësia që edhe pas gjithë këtyre ekzaminimeve dhe analizave arsyeja e sterilitetit të mos zbulohet. Shkaqet e sterilitetit janë të shumta dhe në varësi të shkakut jepet edhe mjekimi poashtu përzgjedhja e metodës me të cilën mjekohen varet edhe nga mosha e partnerëve, kohëzgjatje e sterilitetit dhe shumë faktorë të tjerë. Duke marrë parasysh të gjitha këto dhe nevojat e pacientit nëpër spitale ekzistojnë ekipe të specialistëve të cilët vijnë në përfundimin e zgjidhjes së sterilitetit. Një ndër mënyrat më efikase është aplikimi i metodave të reja biomedicinale. Çifteve nga rrethina e Strugës u rekomandohen spitalet në qytetin e Shkupit si dhe në Manastir, mandej ata vendosin se ku duan të shkojnë.

Megjithatë sipas tyre steriliteti mund të parandalohet me ndryshimin e mënyrës së jetesës, shmangien e sëmundjeve seksualisht të transmetueshme, arritjen e peshës ideale, mospërdorimin e alkoolit, duhanit, vizita më të shpeshta në gjinekologji etj.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut ekzistojnë spitale te të cilat aplikimi i disa prej metodave të reja riprodhuese është i mundshëm, ndër to janë: “ Acibadem Sistina” - Shkup, “ Re-Medika” – Shkup, Strumic, “Spitali Plodnost” – Manastir, te të cilat të gjitha të dhënat në lidhje me pacientët ruhen dhe janë të fshehta.

3.5 Konkluzione dhe Rekomandime

Çështja e prejardhjes biologjike të fëmijës është shumë e rendësishme. Në ligjin për familje të RMV- së njihen e prejardhjes biologjike nuk e kemi të përfaqësuar për arsye se në këtë ligj ndalohet që fëmija i cili ka lindur me anë të inseminimit artificial ose me ndonjërin nga metodat e inseminimit artificial ose fëmija i adoptuar. nuk ka të drejtë që të kërkoj të dhëna për prejardhjen e tij biologjike pasi kjo ruhet si një sekret zyrtar, ndërkaq në Konventën për të Drejtat e Fëmijës një nga parimet kryesore është që fëmija të njoh të drejtën e tij biologjike dhe shtetet këtë duhet tia mundësojnë. Veçanërisht është problematike nëse inseminimi artificial është bërë me material gjenetik të donuar pasi këtu vijnë ndesh dy të drejta, e drejta e anonimitetit të donorit dhe të drejtën e fëmijës për ta njohur prejardhjen e tij biologjike. Disa vende i japin përparësi anonimitetit të donorit dhe ka shtete të cilat nuk e kanë të qartë legjislacionin e tyre. Mbi të gjitha parimi i interesit më të lartë të fëmijës duhet të jetë parim primar në të drejtën familjare mirëpo përsëri vihet në pikpyetje anonimiteti i dhuruesit, këtë problematikë edhe në sistemin tonë juridik ende nuk e kemi të rregulluar. Shteti ynë ka probleme për arsye se ekziston ligji mbi inseminimin e ndihmuar biomedicinal, kemi ligjin për familje dhe nuk kemi harmonizim midis këtyre, nga njëra anë lejojmë që të lindin fëmijë me materiale gjenetike të donuara dhe nga ana tjetër ndalojmë që ky fëmijë të njohë prejardhjen e tij biologjike si dhe poashtu, RMV- ja e ka ratifikuar Konventën Evropiane për të Drejtat e Fëmijëve ku me këtë konvent fëmijës i lejohet të marrë të dhëna për prejardhjen e tij biologjike dhe më pas kjo është çështje mes donatorit dhe fëmijës se çfarë raporti do të ekzistojë midis tyre. Mbi të gjitha fëmija duhet ta dijë prejardhjen biologjike dhe ta formojë identitetin e plotë të tij. Pavarësisht kësaj rol kryesor ka aspekti juridik pasi është ai i cili i analizon të gjitha këto implikime dhe mundohet që të japë përgjigje në shumë probleme lidhur me dilemat të cilat paraqiten me aplikimin e këtyre metodave te personat të cilët mund të kenë probleme. Ligji në legjislacionin tonë ka një pozitë e cila është strikte duke theksuar kështu se pjesëmarrje në këto metoda duhet të kenë vetëm çiftet të cilat janë infertile ose çiftet të cilët nuk mund të lindin në mënyrë natyrore.

Në legjislacionin tonë janë paraparë disa reforma, respektivisht në ligjin për familje dhe ligjin për trashëgimi. Në ligjin për familje të vendosen si mënyrë e themelimit të familjes edhe

këto teknika të reprodukimit artificial dhe të punohet në atë drejtim që Konventen e ratifikuar për të drejtat e femijeve të implementojë ato norma edhe në legjislacionin e brendshëm p.sh. se në lfigjin për amilje është normë imperative se fëmijët e lindur me ndonjërin nga metodat artificiale nuk kanë të drejtë që të njohin prejardhjen e tyre biologjike. Përfundimisht këto reforma duhet të realizohen për mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës.

Një çështje tjetër e cila theksohet ka të bëjë me amësinë surrogate. Ku gjithashtu, e një rëndësie të konsiderueshme është edhe fitimi i të drejtës prindërore nëpërmjet kësaj mënyre biomedicinale. Ligji parasheh regjistrimin e prindërve porositës si prindër biologjik të fëmijës në librin amë të të lindurve, me ç'rast nëna mbajtëse, nuk ka asnjë të drejtë dhe obligim prindëror ndaj fëmijës. Kontraverziteti shfaqet kur nëna mbajtëse duhet të ndjek procedurën juridike për adoptim të fëmijës që ka lindur, në situatat kur prindërit juridikë janë të padenjë për të ushtruar të drejtën prindërore (u hiqet aftësia për të vepruar ose hiqet e drejta prindërore). Në rast se ndodh vdekja e bashkëshortëve, nëna mbajtëse mundet të fitojë kujdestarinë mbi fëmijën e lindur, vetëm nëse fëmija nuk ka familjarë të afërt nga ana e prindërve juridikë. Ligji u përkushton shumë pak vëmendje të drejtave të gruas surrogate, përveç kushteve dhe obligimeve ligjore dhe mjekësore të cilat ajo duhet t'i plotësoj që të realizojë shërbimin e suksesshëm të mbajtjes dhe dhurimin e fëmijës menjëherë pas lindjes. Ligji, gjithashtu, shumë pak i kushton rëndësi përcaktimit të statusit juridik të fëmijës së lindur nëpërmjet kësaj metode. Këto zbrazëtira juridike të këtij ligji, zgjojnë një pyetje tjetër me interes- ky ligj ka për qëllim mbrojtjen dhe realizimin e interesit vetëm të atyre që dëshirojnë të bëhen prindër, apo edhe mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës? Megjithatë frika qëndron në atë se mos ndoshta kjo metodë e riprodhimit do të rikthehet në një biznes me përfitime dhe në këtë rast do të humb kuptimi i familjes tradicionale. Andaj, ligji duhet të jetë më i rreptë në këtë rast, në kuptimin që të dihet se për çfarë arsye ka pranuar nëna surrogate që ta mbajë këtë shtatzani, a e ka bërë këtë si një gjest human apo ka pranuar për arsye ekonomike.

Një çështje tjetër e cila theksohet ka të bëjë me riprodhimin artificial post-mortem ku hasim probleme për statusin juridik të fëmijës. Duke marrë parasysh ligjin për trashëgimi në nenin 122 thuhet: “trashëgimtarë mund të jetë vetëm personi i cili ka lindur i gjallë në momentin e vdekjes së trashëgimtarit ose i cili ka qenë i ngjizur gjatë jetës së trashëgimtarit”. Fëmijës në këtë rast nuk do t'i njihet subjektiviteti juridik në marrëdhëniet trashëgimore pasi ai është

ngjizur pas vdekjes së trashëgimlënësit. Fëmija i lindur nga aplikimi i riprodhimit post-mortem nuk konsiderohet si trashëgimtar për arsye se ngjizja e tij është bërë pas vdekjes së trashëgimlënësit. Mirëpo, ky lloj diskriminimi nuk është i pranueshëm andaj në ligjin për trashëgimi duhet të bëhen ndryshime dhe fëmijëve post-mortem t`u njihet i njëjti status si fëmijet martesor dhe jashtëmartesor.

Përfundimi

Zhvillimi i metodave të reja të riprodhimit artificial ka mundësuar që riprodhimi mos jetë si në të kaluarën, pra vetëm si një proces biologjik që vjen si pasojë e marrëdhënies intime, por ajo zgjerohet edhe më tej duke u bërë një zgjedhje e një apo më tepër personave për t'u bërë prindër. Duke e parë në këtë këndvështrim, qëllimi i këtij punimi u fokusua në dhënien e rekomandimeve konkrete lidhur me mënyrat e moskeqpërdorimit të institutit të riprodhimit dhe me qëllim të mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijës, riprodhimi i cili realizohet përmes këtyre metodave ka nevojë për ndërhyrje më të hollësishme të shtetit.

Si rezultat i hulumtimit janë vërtetuar hipotezat e parashtruara që ishin pjesë e punës kërkimore-shkencore lidhur me këtë temë që paraqet një tabu në shoqërinë tonë, mirëpo një temë shumë e diskutuar në nivel ndërkombëtarë.

Hipotezat e parashtruara për këtë punim janë: e drejta absolute për t'u bërë prind dhe respektimi i interesit të prindërve dhe statusi juridik i fëmijëve të lindur me metodat e riprodhimit artificial dhe respektimi i interesit më të lartë të fëmijës. Lidhur me këto hipoteza pasuan disa pyetje hulumtuese si :

1. Çfarë implikimesh sjellin këto metoda? Me anë të këtyre metodave a respektohet interesi i personave për t'u bërë prindër? A ka ndryshuar koncepti i prindërisë?
2. A respektohet interesi më i lartë i fëmijës së lindur me anë të metodave të riprodhimit artificial.

Sipas pyetjeve të bëra hipotezat u vërtetuan nga shumë aspekte, fillimisht nga anketa e realizuar ku konstatova se zhvillimi i shoqërisë dhe evoluimi i tillë i konceptit të riprodhimit dhe prindërisë nuk është plotësisht i pranueshëm nga normat etike dhe morale. Bioteknologjia ka nevojë për rregullim ligjor, pasi komplikimet e sjella nga aksesi në metodat e reja riprodhuese ndikojnë drejtpërdrejtë në të drejtat themelore të individit. Gjithë këto të drejta por edhe komplikimet të tjera janë në rrezik në momentin kur këto metoda nuk zbatohen brenda standardeve ligjore, etike dhe morale. Gjithashtu, gjatë aplikimit të ndonjërisë nga metodat e riprodhimit artificial është e nevojshme të përcaktohen të drejtat dhe kufizimet e pjesëmarrësve

në aplikimin e këtyre metodave si dhe të bëhet harmonizimi i ligjeve me konventat e ratifikuara, veçanërisht çështja kur kemi të bëjmë me materiale gjenetike të donuara pasi hasim probleme lidhur me njohjen e prejardhjes biologjike dhe anonimitetin e donorit.

Zhvillimi i shpejtë i bioteknologjisë dhe mjekësisë riprodhuese si dhe aplikimi i këtyre metodave shpjen deri në fragmentimin e konceptit të prindërimit dhe familjes tradicionale. Mirëpo jo gjithmonë këto metoda kanë efekt negative pasi falë tyre zgjidhen problemet në lidhje me infertilitetin. I gjithë ky zhvillim ka nevojë për ndërhyrjen e shtetit me qëllim që të bëjë mbrojtjen dhe konzervimin e interesave të personave të cilët marrin pjesë në to. Pamë se gjatë realizimit të disa prej metodave nuk marrin pjesë vetëm prindërit biologjik por edhe persona të tjerë dhe me këtë pozita juridike dhe raporti ndërmjet tyre me fëmijën e lindur nuk është përcaktuar si duhet dhe ka zbrastira juridike që sjellin implikacione për këtë arsye ekziston nevoja e rregullimit ligjor.

LITERATURA

- Arthur Caplan, Janna Merrick, and Robert H. Blank, Human Reproduction, Emerging Technologies, and Conflicting Rights, Congressional Quarterly Press, 1995
- Alison Diduck, Katherine O'Donovan. Feminist perspectives on Family Law. Oxon: Routledge- Cavendish, 2006
- Alexander Sanger, Beyond Choice: Reproductive Freedom in the 21st Century, PublicAffairs, 2004
- Alinčić Mira, Hrabar Dubravka, Jakovac-Lozić Dijana, Korać-Graovac Aleksandra. Obiteljsko pravo. Zagreb, Narodne Novine, 2007
- Barbara Stark. International Family Law- An Introduction, Burlington, Ashgate Publishing Company, 2005
- Baarsma, N. A, The Europeanisation of International Family Law, The Hague, T.M.C. Asser Press, 2011
- Boele-Woelki Katharina , Sverdrup Tone, European Challenges in Contemporary Family Law, Intersentia, 2008
- Buck Trevor, International Child Law, Third edition, London & New York, Routledge, 2014
- Balili Arta Mandro, Meçaj Vjollca, Zaka Tefta, Fullani Arjana, E drejta familijare, Tiranë, 2006
- Дејан Донеv, Александра Деаноска- Трендафилова, Владимир Чадиковски, Петар Атанасов, Дејан Мицковиќ, Ангел Ристов, Маја Парнарџиева- Змејкова, Елена Игновска. “Актуелните биоетички предизвици во Македонија”. Скопје, 2013.
- Дејан Мицковиќ, Ангел Ристов. Семејно право, Скопје: Стоби Трејд, 2015.
- Дејан Мицковиќ, Ангел Ристов, Елена Игновска, Новите репродуктивни технологии и правото, Скопје, 2016
- Dejan Mickovik, Aleksandra Deanoska,, Surrogacy in the West: Giving Birth in the Shadaow of the Law, Lambert Academic Publishing, 2017
- De Cruz Peter, Comparative Healthcare Law, Prinston, 2001
- David K. Gardner, Botros R. M. B. Rizk, Tommaso Falcone, Human Assisted Reproductive Technology: Future Trends in Laboratory and Clinical Practice, Cambridge University Press, 2011
- Davis, D. S., Genetic Dilemmas Reproductive Technology, Parental Choices, and Children's Futures, Oxford University Press, 2010.
- Deech, R. and Smajdor, A., From IVF to Immortality, Controversy in the Era of Reproductive Technology, Oxford University Press 2007.

- Елена Игновска, “Биорепродуктивна етика и право. Новите репродуктивни технологии и родителското право”. Скопје, 2010.
- Elena Ignovska, Sperm Donation, Single Women and Filiation, Intersentia, 2015
- Emily Jackson, Medical Law: Text, Cases, and Materials, Oxford University Press, 2016
- Emily Jackson Regulating Reproduction - Law, Technology and Autonomy, Oxford - Portland, Oregon, 2001.
- Ellen L.K. Toronto, Joann Ponder, Kristin Davisson, Maurine Kelber Kelly (eds.), A Womb of Her Own: Women’s Struggle for Sexual and Reproductive Autonomy, Routledge, 2018
- Foster, C., Choosing Life, Choosing death The Tyranny of Autonomy in Medical Ethics and Law, Oxford and Portland, Oregon, 2009.
- Herring Jonathan, Medical Law and Ethic, Oxford University Press, 2010
- Helen L. Conway, Family Law, London, 2006
- John R. Spencer, Antje Du Bois-Pedain, Freedom And Responsibility in Reproductive Choice, Hart Publishing, 2006
- Janice Raymond, Women as Wombs: Reproductive Technologies and the Battle Over Women's Freedom, Spinifex Press, 1994
- Marie Thérèse Meulders-Klein, Ruth Deech, Paul Vlaardingerbroek, Biomedicine, the Family, and Human Rights, Martinus Nijhoff Publishers, 2001
- Mickoviq Dejan, Ristov Angel, Zakon za semejstvoto, Skopje, Stobi Trejd, 2015
- Mickoviq Dejan, Semejstvoto vo Evropa XVI-XXI vek Skopje, Blesok, 2008
- McGlynn Clare, Families and the European Union: Law, Politics and Pluralism, Cambridge University Press, 2006
- N. Bodiroga-Vukobrat, N. Hlača, D. Hrabar, D. Jakovac-Lozić, A. Korać Graovac, D. Lapaš, I. Majstorović, I. Medić Musa, B. Novak, H. Sikirić, V. Smokvina, S. Winkler, V. Žnidaršič Skubic, M. Župan, Europsko obiteljsko pravo, Narodne Novine, Zagreb, 2013
- Parkinson Patrick. Family Law and the Indissolubility of Parenthood, Cambridge, Cambridge University Press, 2011
- Ruth Deech and Anna Smajdor, From IVF to Immortality: Controversy in the Era of Reproductive Technology, Oxford University Press, 2007
- Rosamund Scott, Choosing Between Possible Lives Law and Ethics of Prenatal and Preimplantation Genetic Diagnosis, Oxford and Portland, Oregon, 2007.
- Rešetar, B., Aras Kramar, S., Lucić, N., Medić, I., Šago, D., Tucak, I. I Mioč, P. Suvremeno obitljsko pravo i postupak, Pravni fakultet, Osijek, 2017

- Sherpe Jens Martin. European Family Law - Volume II, The Changing Concept of Family and Challenges for Domestic Family Law. Cheltenham, UK: Edward Elgar, 2016

ARTIKUJ

- Arta Selmani- Bakiu, Emine Zendeli, Право на детето да го знае своето потекло. In Proceedings of the 3-rd International Scientific Conference- Ohrid School of Law. Effective Protection of the Human Rights and Liberties. Reality or Idea, pp. 231 – 250. [http://www.iuridicaprima.mk/content/files/TOM%205%20finalno%20\(1\)%20\(1\).pdf](http://www.iuridicaprima.mk/content/files/TOM%205%20finalno%20(1)%20(1).pdf)
- Arta Selmani, Стекнување на родителското право преку сурогат мајка- посебен осврт на Законот за изменување и дополнување на законот за биомедицинско потпомогнато оплодување (Proceeding of the Third International scientific conference Social change in the global world- Center for Legal and Political Research, Faculty of Law, Goce Delcev University, Shtip, Republic of Macedonia) p.129-152 , 2016
- Abraham Benschushan & Joseph G.Schenker, The right to an heir in the era of assisted reproduction, Human Reproduction vol.13 no.5 p.1407–1410, 1998
- Chaves M. Homoeffective Parentage in Relation to Medically Assisted Reproduction: a Paralel betwen Brazil and Portugal. U B. Atkin (ed.) The nternational Survey of Family Law (Bristol: Jordan Publishing Limited), 2011
- Curry-Sumner I., M. Vonk, National and International Surrogacy: An Odyssey. U B. Atkin (ed.) The International Survey of Family Law (Bristol: Jordan Publishing Limited), 2011
- Curry-Sumner I., M. Vonk, National and International Surrogacy: Something Old, Something New, Something International and Something Asked. U B. Atkin (ed.) The International Survey of Family Law (Bristol: Jordan Publishing Limited), 2012
- Дејан Мицковиќ, Ангел Ристов, Биомедицински потпомогнато оплодување во Република Македонија, во Актуелните биоетички предизвици во Македонија, Ламина, Скопје, 2013.
- Дејан Мицковиќ, Договорите за сурогат мајчинство: етички и правни аспекти, Копаоничка школа природног права, Правни живот, 2008.
- Дејан Мицковиќ, Дилеми во врска со законот за биомедицински потпомогнато оплодување, Правник, Скопје, март 2009.
- Дејан Мицковиќ, Постхумната репродукција и наследното право, Zbornik Pravnog fakulteta u Zagrebu, Vol. 61, Br. 2, Zagreb, 2011.
- Дејан Мицковиќ, Правните и етичките дилеми што произлегуваат од Законот за биомедицински потпомогнато оплодување на Република Македонија, Зборник од Првата меѓународна интердисциплинарна конференција „Биоетика-знак на новото доба: Биоетиката, медиумите, правото и медицината, Универзитет „Св. Кирил и Методиј,, Правен факултет На,,Јустинијан Први,, Скопје, 2012.

- Dejan Mickovik, Katerna Kockovska, Biomedically assisted fertilization in Macedonia and Slovenia, *Iustinianus Primus Law Review*, No. 6, 2013.
- Dejan Mickovik, Osnovne eticke i pravne dileme prilikom regulisanja medicinski potpomognute oplodnje u evropskim zakonodavstvima, *Harmonius* br. 2, Beograd, 2014.
- Дејан Мицковиќ, Сурогат мајчинството во Република Македонија, Охридска правна школа, „Новите предизвици во уредувањето на правните односи во духот на Европските вредности“, *Juridica, Journal of Legal and Social Studies*, Скопје, 2015.
- Дејан Мицковиќ, Статусот на ембрионот во современите законодавства, *Iuridica Prima, Institute for Legal – Economic Research and Education, International Scientific Conference, Ohrid School of Law*, No. 2016.
- Dejan Mickovik, Regulisanje surogat materinstva u savremenim zakonodavstvima, *Zbornik radova “Nacionalno i međunarodno pravo-aktuelna pitanja i dileme”*, Tom I, Univerzitet u Prištini sa privremenim sedištem u Kosovskoj Mitrovici, Kosovska Mitrovica 2017.
- Дејан Маролов, Елена Иванова. Етичките аспекти на сурогатството наспроти ставовите на законската регулатива. Годишен зборник на Правен факултет, 2015
- Dejan Mickovic, Angel Ristov. “Biomedical assisted fertilization in Macedonia, Serbia and Croatia: Ethical and legal aspects.
- Гордана Ковачек Станић, Породичноправни аспект биомедицински потпомогнутог оплођења у праву Србије и европским правима, *Зборник матице српске за друштвене науке*, свеска 131, 2010.
- John A. Robertson. Legal Change and Stigma in Surrogacy and Abortion. *J Law Med Ethics*. 2015
- John A. Robertson. Legal Change and Stigma in Surrogacy and Abortion
- Маролов Дејан, Максимова Елена. Етичките аспекти на сурогатството наспроти ставовите на законската регулатива.
- Natalie Fixmer – Oraiz. Speaking of Solidarity. *Transnational Gestational Surrogacy and the Rhetorics of Reproductive (In)Justice*.
- Олга Цвејић Јанчић, Зачеће уз помоћ медицине и права детета, *Анали Правног факултета у Београду*, бр. 2-3, 1992
- Roberts, J., *Commerce & Regulation in the Assisted Reproduction Industry*, *Texas Law Review*, Vol. 85, 2007.
- Schenner, J, G., *Assisted Reproduction Practice in Europe: Legal and Ethical Aspects*, *Human Reproduction Update*, Vol. 3, No. 2, 1997

LIGJET DHE DOKUMENTET NDËRKOMBËTARE

- Additional Protocol to the Convention for the Protection of Human Rights and Dignity of the Human Being with regard to the Application of Biology and Medicine, on the Prohibition of Cloning Human Beings (1998).
<https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/168>
- Convention on the Rights of the Child, (1989).
<http://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/crc.aspx>
- Convention for the Protection of Human Rights and Dignity of the Human Being with regard to the Application of Biology and Medicine: Convention on Human Rights and Biomedicine (1997), <https://rm.coe.int/168007cf98>
- Directive 2004/23/EC of the European Parliament and of the Council of 31 march 2004 on setting standards of quality and safety for the donation, procurement, testing, processing, preservation, storage and distribution of human tissues and cells.(2004)
<https://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2004:102:0048:0058:en:PDF>
- Directive 2006/86/EC of 24 October 2006 implementing Directive 2004/23/EC of the European Parliament and of the Council as regards traceability requirements, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32006L0086>
- “Ligji për ndryshime dhe plotësime të ligjit për mbarësim të ndihmuar biomedicinal”
Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.149/2014
- Ligji për inseminim të ndihmuar biomedicinal, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.37/2008
- The Convention on the Elimination of All Forms of Discrimination against Women, 3.09.1981, <http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/cedaw.htm>
- The European Convention on Human Rights, 4.11.1950,
http://www.echr.coe.int/Documents/Convention_ENG.pdf

BURIME NGA INTERNETI

- Addendum to the Replies to questionnaire on access to medically assisted procreation (MAP), on right to know about their origin for children born after MAP \
- European Court of Human Rights, Case Law/ data base (Article 8)
[https://hudoc.echr.coe.int/eng#{"sort":\["kpdate%20Descending"\],"kpthesaurus":\["425","429"\],"documentcollectionid2":\["DECISIONS"\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{)
- Human Rights in the Biomedical Field, www.coe.int/bioethics
- Medically assisted procreation and the protection of the human embryo comparative study on the situation in 39 states,
<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016803113ec>

- Replies by the member States to the questionnaire on access to medically assisted procreation (MAP), on the right to know about their origin for children born after MAP and on surrogacy, <https://rm.coe.int/inf-2016-4-map-replies-e/1680939b71>
- Replies by the member States to the questionnaire on access to medically assisted procreation (MAP) and on right to know about their origin for children born after MAP
<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016803113e9>
- Recommendations.Resolutions.Reports. Questionnaires Compendium of texts of the Council of Europe on Bioethical Matters,
https://www.coe.int/t/dg3/healthbioethic/texts_and_documents/
- The Protection of the Human Embryo In Vitro,
<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016803113e6>
- <https://www.coe.int/en/web/bioethics/embryo>
- <https://netpress.com.mk/foto-prvo-makedonsko-semejstvo-dobi-bebe-od-surogat-majka/>
- [http://www.iuridicaprima.mk/content/files/TOM%205%20finalno%20\(1\)%20\(1\).pdf](http://www.iuridicaprima.mk/content/files/TOM%205%20finalno%20(1)%20(1).pdf)
- http://portal.unesco.org/en/ev.phpURL_ID=31058&URL_DO=DO_TOPIC&URL_SECTION=201.html
- Charter of Fundamental Rights of the European Union. 2007 <https://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:C:2007:303:0001:0016:EN:PDF>